



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 205/9 prot.

Tiranë, më 28. 08. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 172, datë 28. 08. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr. 22 Regj., datë 06.02.2023, e Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, përfaqësuar nga A. A., kundër Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, përfaqësuar nga A. P. dhe A. G., me pretendim diskriminimin për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Në datën 23 nëntor 2022, A. P. ka transmetuar live në profilin e tij social në Facebook për rreth 90 minuta një mbledhje të grupimit të quajtur “Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës”. Mbledhja u ndoq në kohë reale nga rreth 5600 persona dhe u shpërnda mbi 250 herë. Takimi ishte gjithashtu i hapur për disa media prezente në sallë. Qëllimi i mbledhjes ishte trajtimi i një çështjeje që sipas A. P. ishte urgjente dhe përfshinte “mbrojtjen e vlerave, jetës dhe identitetit të femijëve përballë komunitetit gej<sup>2</sup>”, pasi “të vegjëlve u mësohet se është normale që dy djem apo dy vajza të nisin një romancë dashurie mes tyre” dhe se “këto modele hyjnë në ëndrrat e vogëlushëve mes botës së heronjve”, “shtriga e Hirushes po portretizohet si një burrë i veshur me fustan; Borëbardha megjithëse ka lindur vajzë ndjehet djalë dhe nuk bie në dashuri me princin, por me një princeshë” etj. Këto fakte nuk figurojnë askund përveçse në fjalët e A. P., por ato merren të mirëqena nga të paktën 5600 ndjekës të kësaj shfaqjeje, ku theksohet se ekziston një projekt i udhëhequr nga komuniteti LGBTI+ për “dëxhenderizimin” e shoqërisë që synon të arrihet mes kurrikulave shkollore që herët ose vonë do të pasqyrojnë informacione për komunitetin LGBTI+ si dhe botës së artit.

Më tej A. P. vijon të shpjegojë më qartësisht qëllimin urgjent të mbledhjes që ishte ndalimi i shfaqjes së filmit “Strange World”, i prodhuar nga Disney dhe që ishte planifikuar të

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

<sup>2</sup> Minuta 1-5

transmetohej te Kinema “Millenium” në datën 24.11.2022, ora 10:40. Sipas deklaratave të A. P. ky film seksualizon fëmijët dhe përpiqet t’i “dëxhenderizojë” ata, si pjesë e agjendës agresive gej”, askush nuk ka të drejtë të dëmtojë ëndrrat e fëmijëve tanë dhe t’u tregojë se pavarësisht se ata kanë lindur djem ose vajza, më e rëndësishmja është se si ata ndihen”, kjo agjendë është një regres i madh shpirtëror dhe njerëzor”. Më tej u komunikua se në mbledhje do të diskutoheshin hapat që koalicioni do të ndërmernte në një mënyrë “jo-diskriminuese” për të vendosur disa pika mbi “i”, duke bërë qëndresën tonë, ngjashëm me vende si Hungaria e Çekia, që kanë politika prezente që nuk nxisin shpopullimin, por prokrijimin.

Gjatë takimit, A. G. u shpreh se në datën 24.11.2022 do të shfaqej në kinema një film që kërkon t’u mësojë fëmijëve se të qenit homoseksualë është normale. Ky film është problem i Disney, por bëhet problemi jonë. A. G. u shpreh se ky film është një kurth, pasi kinemaja nuk u ofron informacione prindërve mbi përmbajtjen e tij homoseksuale dhe se në Shqipëri ka ardhur momenti të shihet përmbajtja e filmave të shfaqur për fëmijë, pasi ato shfaqin personazhe LGBTI+. Më tej A. G. u shpreh se shfaqja e nesërme ka një urgjencë sepse mund të dëmtojë shëndetin mendor, emocional dhe të ndikojë negativisht në shumë fëmijë. U shpjegua se mbledhja kishte për qëllim informimin e gjerë të publikut, të mbronte të drejtat ligjore, jetën dhe familjen. U ftuan pjesëmarrësit që në datën 24.11.2022 t’i bashkoheshin koalicionit në shpërndarjen e informacionit mbi filmin, si dhe u njoftua se do t’i shkruhej një letër Kinemasë “Millenium”. A. G. u shpreh se do ti drejtoheshin kinemasë për ta njoftuar për bojkotin e këtij filmi dhe se do t’i jepnin 24 orë kohë, ku nëse Kinemaja nuk e bllokoi shfaqjen e këtij filmi, do ta bojkotonin pa afat Kinemanë në fjalë, me synimin që të kishin “një ndikim<sup>3</sup>” te Kinemaja. Po kështu u propozua marrja e masave për kontrollin e programacionit për fëmijë që shfaq personazhe LGBTI+ në televizion, mes takimeve të ndryshme me AMA apo bordin e programacionit të RTSH-së, pasi anëtarët e këtij koalicioni e kishin këtë të drejtë si taksapagues shqiptarë. Gjatë fjalës së tij A. G. theksoi edhe se siç u ishte treguar edhe në SMS-të që u niseshin paraprakisht nga koalicioni anëtarëve të tij, kishte plane për ndërhyrje në kurrikula mbi paraqitjen e temave LGBTI+ dhe se “agjenda gej globaliste po përparon në dëm të familjes dhe fëmijëve”.

Takimi vijoi edhe me shumë ndërhyrje nga të ftuar të ndryshëm dhe deklarata shtesë nga A. P. dhe A. G..

Në datën 24.11.2022 sikurse lajmëruan në mbledhjen e sipërcituar, përfaqësues të Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës u mblodhën jashtë Kinema “Millenium” nga ku bënë thirrje publike dhe ishin të gatshëm të shpërndanin materiale të shkruara, të pretenduara si informuese mbi përmbajtjen e filmit që ishte programuar të shfaqej. Thirrjet u transmetuan live në televizione të ndryshme kombëtare, si FOX News. Po kështu shumë portale online publikuan këto thirrje, çka u pasua nga komente të shumta që përmbajnë gjuhë diskriminuese dhe urrejtjeje ndaj personave LGBTI+. Objekti i thirrjeve ishte fakti se transmetimi i përmbajtjeve LGBTI+ për fëmijë ishte e rrezikshme për ta. Gjithashtu u tha se komuniteti LGBTI+ “filloi me prindin 1 dhe 2, vijoi me projektin për futjen në kurrikula shkollore të mësimëve homoseksuale dhe sot po del në një pikë akoma më sensitive”, “ky komunitet u jep fëmijëve modele të shtrembëruara, të cilat janë homoseksuale dhe shkaktojnë probleme të rënda psikike te fëmijët, siç i kemi parë në vendet

---

<sup>3</sup> Minuta 27-28

perëndimore”, “u tregohet fëmijëve se të jesh homoseksual është normale”. Këto thirrje arritën te të paktën 7800 persona vetëm mes rrjetit social facebook, pa llogaritur audiencën që i ka ndjekur ato nga televizioni.

Rreth orës 10:30, disa aktivistë të Aleancës LGBTI+ i janë drejtuar ambienteve të kinemasë Millenium për të ndjekur filmin “Strange World”, sipas njoftimit zyrtar të kinemasë lidhur me datën dhe orarin e shfaqjes, por në recepsion u njoftuan se shfaqja e filmit ishte anuluar jo vetëm sot, por se filmi nuk do të shfaqej më në kinema Millenium, “pasi nuk e kishin marrë fare si film” etj.

Në kuadër të këtij seksioni të ankesës dëshirojmë të sjellim në vëmendje se filmi në fjalë, sipas përshkrimit zyrtar të tij, nuk ka në thelb tematikën e identitetit gjinor apo orientimit seksual, por rrugëtimin fantastik të një grupi personazhesh drejt shpëtimit të planetit. Mes gjithë personazheve të filmit, portretizohet edhe një personazh i cili shpreh pëlqimin e tij ndaj një personazhi të gjinisë së njëjtë.

Thirrjet e drejtuara nga Koalicioni Pro Familjes dhe Jetës, mes deklaratave të A. P. dhe A. G., por edhe përfaqësuesve të tjerë, të cilat vetëm në bazë të provave që kemi bashkëlidhur kësaj ankese kanë arritur minimalisht një audience prej rreth 8000 persona, kanë një karakter të pakontestueshëm përjashtues, denigrues, fyes, stigmatizues, si dhe stereotipizojnë negativisht individët dhe fëmijët LGBTI+ (një i mitur LGBTI+ ishte edhe personazh i filmit) si jo normale, kundër vlerave morale dhe familjes, me një agjendë agresive dhe si persona e fëmijë me probleme të rënda psikike dhe të formimit.

Këtë aksion, këto thirrje, si dhe materialet e shpërndara gjerësisht në rrjetet sociale dhe fizikisht afër ambienteve të Kinema Millenium përmbajnë elemente të diskriminimit të drejtpërdrejtë, diskriminimit të tërthortë, gjuhës së urrejtjes, nxitjes/ndihmës për diskriminim, udhëzimit për të diskriminuar në kuptim të nenit 3 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i përditësuar, në bazë të shkaqeve të pretenduara në pikën 2 të kësaj ankese.

Nuk dëshirojmë të paragjykojmë në asnjë moment vendimin e Kinema Millenium për anulimin e shfaqjes së filmit në momentin e fundit, por kemi një dyshim të arsyeshëm e të bazuar se thirrjet e Koalicionit në fjalë mund të kenë qenë të asaj natyre dhe intensiteti sa të mund ta kenë ndikuar marrjen e këtij vendimi. Megjithatë, edhe nëse ky fakt është i vështirë për t’u provuar, ka patur pa dyshim një kërkesë publike të Koalicionit për mosshfaqjen e filmit ndaj Kinemasë, e cila u kërcënua me bojkot nëse nuk do ta anulonte shfaqjen brenda 24 orëve. Kjo kërkesë bazohet në fakte të paprovuara shkencërisht dhe në thirrje që portretizojnë individët dhe fëmijët LGBTI+ si jonormalë, të cilat përbëjnë diskriminim për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit dhe ndalohen nga neni 5 i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i përditësuar.

Mes arritjes së një publiku të gjerë prej të paktën 8000 personash, thirrjet e sipërcituara nuk mund të konsiderohen të izoluara dhe as të justifikohen në kuadër të parashikimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në mbrojtje të lirisë së shprehjes, pasi kanë të gjitha shanset të ndikojnë negativisht në perceptimin publik ndaj çështjeve LGBTI+, duke nxitur portretizimin dhe shikimin e personave dhe fëmijëve LGBTI+ si jonormalë, çka mund të rezultojë në rritjen e niveleve të diskriminimit në të ardhmen.

Citimi nga A. P. i modeleve Hungareze, Polake apo Çeke si modele për mbarëvajtjen dhe ardhmërinë e Shqipërisë dhe Koalicionit, është një precedent i rrezikshëm që dëshmon sërish qëndrimin e tij diskriminues ndaj çështjeve të komunitetit LGBTI+. Këto shtete njihen në Evropë si dy nga shkelëset kryesore të të drejtave të njeriut, çka reflektohet në masat ligjore të ndërmarra ndaj tyre nga Komisioni Evropian për shkak të shkeljeve flagrante që kanë kryer ndaj të drejtave të personave LGBTI+<sup>4</sup>.

Asnjë nga aktet dhe thirrjet që kemi parashtruar në këtë ankesë nuk i konsiderojmë brenda objektit të së drejtës për liri të shprehjes, por si gjuhë urrejtjeje e diskriminim të pastër. Në bazë të nenit 10 të KEDNJ-së, e aplikueshme brenda territorit dhe juridiksionin shqiptar, referuar shkurtimisht jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjet Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Ebakan kundër Turqisë, vlerat e demokracisë si toleranca dhe respekti ndaj dinjitetit të barabartë të çdo qenieje njerëzore kërkojnë kufizimin e lirisë së shprehjes sa herë është e nevojshme në një shoqëri demokratike, e sidomos për të ndaluar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes që shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtje bazuar në mungesën e tolerancës dhe që shkaktojnë ofendime apo shqetësim ndaj grupimeve të caktuara të shoqërisë<sup>5</sup>. Gjithashtu, sjellim në vëmendje çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë. Në këtë çështje përfaqësues të një grupimi me elemente fetare shpërndanë thirrje dhe broshura drejtuar prindërve, nxënësve dhe stafëve akademike ku thuhej:

“Propaganda homoseksuale”

‘Në rrjedhën e disa dekadave shoqëria ka kaluar nga refuzimi i homoseksualitetit dhe devijimeve të tjera seksuale në përqafimin e kësaj prirje devijante seksuale. Mësuesit anti-suedezë e dinë shumë mirë se homoseksualiteti ka një efekt moral destruktiv në substancën e shoqërisë dhe pse ata përpiqen ta paraqesin atë si diçka normale.

Thuajuni prindërve se organizatat lobuese homoseksuale po përpiqen gjithashtu të minimizojnë shturjen. Pyetini prindërit nëse ky devijim seksual duhet të legalizohet.”

Argumenti kryesor i paraqitur nga ky grupim në kuadër të çështjes së ngritur ndaj tyre për përhapje të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit mbështetet kryesisht në parashikimet e neneve 9 dhe 10 të KEDNJ-së, duke prekur lirinë e tyre të ndërgjegjes dhe fesë, si dhe lirinë e shprehjes dhe mendimit.

Në një arsyetim të kujdesshëm, i cili konsideroi me hollësi përmbajtjen e këtyre thirrjeve, GJEDNJ vendosi se natyra e këtyre thënieve nuk mund të konsiderohej brenda nivelit të lirisë së shprehjes dhe se shtetet anëtare të KEDNJ-së duhet të tregoheshin të kujdesshme në kufizimin e arsyeshëm të lirisë së shprehjes për të parandaluar deklaratat “fyese të pajustificuara” dhe diskriminimin kundrejt një grupi të caktuar, mes një testi që paraqet një prag edhe më të ulët se “gjuha e urrejtjes”<sup>6</sup>.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

- shqyrtimin e kujdesshëm të kësaj ankese nga institucioni i Komisionerit;

<sup>4</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_3668](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_3668)

<sup>5</sup> [https://www.echr.coe.int/documents/fs\\_hate\\_speech\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/fs_hate_speech_eng.pdf)

<sup>6</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%5B%22001-109046%22%5D%7D>

- marrjen e një vendimi të drejtë që tregon kujdes të veçantë në konsiderimin e raportit të hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe konstatimin e elementeve të ndryshme diskriminuuese në lidhje me momentet e parashtruara më sipër, në funksion të shmangies dhe parandalimit të praktikave të rrezikshme për demokracinë dhe të drejtat e njeriut e Shqipëri.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

*“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me këto shkaqe.

**Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

1. Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.



Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

.....

b) legjitimimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligj.”

Referuar parashikimit të shkronjës b), të pikës 1, të nenit 32, të ligjit të sipërpërmendur rezulton se Komisioneri shqyrton ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve, ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive.

“Interesi i ligjshëm” është elementi fillestar që duhet të plotësohet nga një organizatë, që depoziton ankesë pranë Komisionerit, për mbrojtje të interesave të një komuniteti të caktuar, që nënkupton legjitimimin e saj në kryerjen e ankesës.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 722, datë 01.03.2012, nëpërmjet së cilit Qendra “Të bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri” është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të komunitetit LGBT në Shqipëri.

Mbështetur në përmbajtjen e aktit e regjistrimit dhe Statutin e Qendrës, rezulton se forma e organizatës jofitimprurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

“- Të mbrojtë të drejtat e çdo personi LGBT në Shqipëri;

- Të llobojë dhe advokojë për dhe në emër të komunitetit LGBT në Shqipëri;

- Të informojë institucionet shtetërore, Qeverinë shqiptare, publikun e gjerë, komunitetin LGBT dhe organizatat ndërkombëtare për situatën e të drejtave të komunitetit LGBT në vend;

- Të ndërgjegjësojë institucionet shtetërore, Qeverinë shqiptare, publikun e gjerë dhe familjet për respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT;

- Të asistojë komunitetin LGBT dhe të vendosë në dispozicion të tyre mjete, që bëjnë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së këtij komuniteti në jetën publike të vendit dhe në vendimmarrje, në nivel qendror dhe lokal;
- Të bashkëpunojë me organizat brenda dhe jashtë Shqipërisë për avancimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri;
- Të punonjë për përmirësimin e legjislacionit, politikave dhe standardeve për të drejtat e personave LGBT në Shqipëri;
- .....
- Të promovojë respektimin e Konventave dhe akteve ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës etj, që mbrojnë e garantojnë të drejtat e personave LGBT, të drejtat e njeriut, të grave, të minoriteteve etj”.

Qëllimi kryesor i Qendrës, sipas parashikimit të bërë në nenin 3, të Statutit, është të mbrojë dhe të promovojë respektin për të drejtat e homoseksualëve, lesbikeve, biseksualëve dhe transeksualëve.

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 722/4, datë 29.12.2022, A. A. është zgjedhur Drejtore Ekzekutive e Qendrës, e cila bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 14, të Statutit, ka tagrin e përfaqësimit të Qendrës në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët janë e ndjehen pjesë e komunitetit LGBTI. Mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës, sipërcituar në vendim, Komisioneri gjykon se Qendra, përfaqësuar nga A. A., Drejtore Ekzekutive, legjitimohet dhe ka tagër për të bërë ankesë në emër të mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI.

2. Me shkresën nr. 205/1 prot., datë 14.02.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, A. P. dhe A. G., që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën<sup>7</sup> datë 08.03.2023, A. G. kërkoi nga Komisioneri ndër të tjera vënien në dispozicion të një kopje të ankesës dhe dokumentacionit bashkëgjitur saj.

3. Duke qenë se me A. P. dhe Koalicionin Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, nuk u arrit të kontaktohej nëpërmjet postës, për shkak të mungesës së adresave zyrtare, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 22.02.2023, iu drejtua sërish A. P. duke e informuar lidhur me ankesën dhe kërkuar informacion lidhur me të.

<sup>7</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 205/2 prot., datë 08.03.2023

Në përgjigje të *e-mail*-it të sipërcituar, A. P., me anë të *e-mail*-it datë 06.03.2023, kërkoi nga Komisioneri ndër të tjera, vënien në dispozicion të një kopje të ankesës dhe dokumentacionit bashkëgjitur saj.

4. Me *e-mail*-in datë 08.03.2023, Komisioneri i përcolli A. P. një kopje të ankesës (nr. 22 Regj., datë 06.02.2023, të Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”) dhe dokumentacionin bashkëgjitur saj, si dhe kërkoi informacion dhe parashtrime sa i përket pretendimeve të ngritura në të nga ana e subjektit ankues.

Në përgjigje të *e-mail*-it të sipërcituar, A. P. me anë të *e-mail*-it datë 16.03.2023, përcolli pranë Komisionerit parashtrimet e tij sa i përket ankesës së paraqitur nga Qendra “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”. Ndër të tjera A. P. sqaroi se: “A- Zoti Av. A. G. nuk është përfaqësues i Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës. Përfaqësuesit e koalicionit i gjeni në linkun e uebsitit të koalicionit: <https://profamalb.com/>.”

B- Organizimi i takimit dhe bërja publike e mesazheve që janë përcjellë nga unë personalisht kanë pasur vetëm këto synime: Informimin e prindërve mbi titullin e ndryshuar në përkthimin Shqip të filmit ‘Strange World’ që në Shqip përkthehet në ‘Botë e Çuditshme’ në titullin e publikuar të përkthyer ndryshe nga titulli origjinal, në: ‘Botë e Mrekullueshme’. Gjithashtu informimin e prindërve dhe familjarëve të fëmijëve mbi tematikën dhe përmbajtjen e filmit. Hapi i informimit paraprak mbi përmbajtjen e filmit është parë i nevojshëm, nisur nga dëshira e mirë për t’i dhënë prindërve dhe familjarëve të fëmijëve alternativën e zgjedhjes.

C- Nga shqyrtimi i kujdesshëm i videos përgjatë gjithë komunikimit tim, nuk gjejmë në asnjë moment evidenca që lidhen me fyerje dhe as diskriminim por shprehje të një opinioni brenda lirisë së shprehjes dhe fjalës, të drejta këto të garantuara nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Të konsumosh diskriminim do të thotë të krijosh një pasojë që e pengon të diskriminuarin të trajtohet në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Nuk ka asnjë evidencë të pasojave të krijuara nga komunikimi im.

D- Dy citime të rëndësishme nga transkripti i fjalës time të cilat evidentojnë qëndrimin tim në raport me personat me orientim ndryshe seksual: “së bashku me ju miq gazetarë, prindër, baballarë dhe nëna, avokatë dhe avokate, të diskutojmë dhe të trajtojmë me kujdes se cilat janë hapat që ne duhet të ndërmarrim në një mënyrë jodiskriminuese, në një mënyrë me etikë, në një mënyrë qytetare...” “Natyrisht që çdo maxhorenë homoseksual dhe këtë do ta them, të dashur miq, çdo maxhorene lesbike ka të gjithë të drejtën e botës dhe të Zotit, mbase jo të Zotit, por të jetës dhe të zgjedhjes së tyre që ta orientojnë seksualitetin, jetën e tyre si ta duan ata, por larg duart nga fëmijët tanë.” Ju lutem vini re që në asnjë moment në komunikimin tim nuk kam përmendur e as kam folur për “fëmijë lgbt” por kam folur mbi termin “fëmijët tanë”.

Unë besoj që fëmijët nuk duhet të seksualizohen, por duhet të jenë fëmijë të cilët jetojnë fëmijërinë e tyre. Është detyra e të gjithëve ne, përfshi dhe Institucionin e Komisionerit kundër Diskriminimit që t’ua garantojmë fëmijëve Shqiptarë këtë të drejtë. Mendoj se nëse është fjala për diskriminim, personi i diskriminuar jam unë. Nga grupi LGBTIQ+ jam i monitoruar në çdo komunikim tim publik në televizione dhe në median sociale. Ndihej i përndjekur dhe nën vëzhgim në çdo kohë. Më është censuruar liria e ndërgjegjes, fjalës dhe besimit. Madje drejtues të këtij



komuniteti janë duke përndjekur publikisht dhe familjarë të mi, fatkeqësisht duke keqpërdorur Institucionin dhe emrin e Komisionerit për të censuruar të drejtën e fjalës time dhe të familjarëve të mi në publik. Kjo ka ndodhur në debate televizive live, në programe të mirënjohura televizive dhe ndjekura nga shumë njerëz ku drejtues të grupit LGBTQ+ i janë drejtuar bashkëshortes time duke i thënë që nuk ka të drejtë të flasë, sepse sipas tyre Komisioneri kundër diskriminimit ka marrë vendim që ne (si çift bashkëshortësh) kemi pëdorur gjuhë urrejtje në publik ndaj grupit LGBTQ+ dhe kur bashkëshortja ime ka shprehur se ajo nuk ka qenë asnjë herë tek Institucioni i KMD dhe nuk ka asnjë vendim për të, atëherë përgjigja nga drejtues të grupit LGBTQ+ live në program ka qenë: “Për shkak se ka një vendim për burrin tënd dhe ti nuk duhet të flasësh.” Kujdes! Këto janë rikthime në publik të kulturës së përndjekjes që diktatura komuniste aplikonte ndaj familjarëve të afërt të personave të cilët ishin dënuar dhe shpallur armiq të popullit. Familjarët mbanin mbi vete peshën e ‘njollës’ në biografinë e tyre. Ata ishin të monitoruar dhe mbaheshin nën vëzhgim të vazhdueshëm, ndërsa syrgjynoseshin në kampet e punës së detyruar.

E- Në takimin e 22 Nëntorit unë kam përmendur politikën fiskale pro familjes që Qeveria Hungareze aplikon ndaj qytetarëve të saj. Duke theksuar se implementimi i disa prej këtyre politikave fiskale në Shqipëri do të ndikonte drejtpërdrejtë në fuqizimin e familjes dhe uljen e shpopullimit të Shqipërisë, plagë që e vuajmë të gjithë në Shqipëri. Nuk kuptoj se cila është pjesa diskriminuese nga ana ime në këtë pjesë të fjalimit? Ndërkohë në ankesën e ngritur nga drejtues të organizatës LGBTQ+ stereotipizohet Hungaria dhe Çekia duke iu referuar modeleve të politikave të tyre profamiljes si precedentë të rrezikshëm. Citoj: “Citimi nga A. P. i modeleve Hungareze, Polake apo Çeke si modele për mbarëvajtjen dhe ardhmërinë e Shqipërisë dhe Koalicionit, është një precedent i rrezikshëm që dëshmon sërish qëndrimin e tij diskriminues ndaj çështjeve të komunitetit LGBTI+. Këto shtete njihen në Europë si dy nga shkelëset kryesore të të drejtave të njeriut, çka reflektohet në masat ligjore të ndërmarra ndaj tyre nga Komisioni Europian për shkak të shkeljeve flagrante që kanë kryer ndaj të drejtave të personave LGBTI+.”

Këtu po vendos nga transkripti i komunikimit tim çfarë unë kam thënë mbi politikën fiskale të Qeverisë Hungareze për familjen: “Unë mendoj që kemi nevojë që të shikojmë dhe të marrim modelet më të mira lidhur me ekonominë, lidhur me ligjet, lidhur me shoqërinë por natyrisht duhet të marrim gjërat më të mira dhe vlerat më të mira dhe nga ato vende të cilat janë në avantgard të mbrojtjes së familjes mbi këto çështje që lidhen me kulturën, me identitetin, me gjininë, me botën e shpirtit në doni, por edhe me politikën sociale të cilat janë shumë herë më përpara vendeve të tjera perëndimore të cilat ne si shqiptarë i kemi aspiruar prej dekadash me radhë për të qenë pjesë e strukturave të tyre, vende si Hungaria, vende si Çekia, vende si ajo pjesë e atij blloku në qendër të Europës të cilat deri diku nga mediat liberale në vendin tonë janë paragjykuar, janë tjetërsuar përmes një komunikimi publik, lidhur me të ashtuquajturën një përjasje arkaike mbi jetën, mbi botën, mbi shoqërinë dhe mbi vlerat, mua më rezultojnë krejt ndryshe. Shkoj në Hungari dhe shikoj që hungarezët nuk duan të largohen nga vendi i tyre, sepse shteti i tyre është duke mbështetur familjen, është duke mbështetur fëmijët, është duke mbështetur çiftet e reja. E kam thënë dhe nga Hungaria, nga Budapesti që kam parë jetën e cila gëlonte në Budapest. Shikoja fëmijë të vegjël të kapur për dore, djem dhe vajza që shkonin nga shkolla në park, nga parku shkonin në një kinema, pra një ambient i cili ishte i mbrojtur, një ambient i cili ishte i sigurt për ndërtimin e jetës së fëmijëve, politika sociale të cilat natyrisht nuk nxisin dhe

motivojnë shpopullimin e vendeve si Hungaria dhe vende të tjera, por përkundrazi nxisin prokrijimin, lindshmërinë e fëmijëve nga çiftet e reja, nxisin hungarezët e rinj të aspirojnë ëndrrat e tyre të mëdhaja për të ndërtuar jetën e tyre në Hungari. Nuk kam takuar një hungarez që do të largohet nga vendi i tij, kam parë dhe kam takuar gra të reja shtatzënë të cilat më thonin që shteti hungarez i mbështeste me 26'000 euro, nga muaji i parë i shtatzënisë së tyre deri në ditën e lindjes si një bonus lindje për fëmijën. Kam parë çifte të reja të cilët aspironin të ndërtonin një shtëpi, sepse shteti hungarez, përmes politikave sociale i mbështeste deri në 60% me bonus ndërtimin e një shtëpie, 60% të vlerës financiare dhe me 40% e mbetur nëpërmjet sistemit bankar të bankave të nivelit të dytë, shteti garantonte sigurinë e kredive me interes 0. Kam parë dhe kam dëgjuar nga familje hungareze të cilat më thonin që një njeri, deri në moshën 25 vjeç i cili punon, përjashtohet nga taksa mbi pagën. Për një familje që ka 4 fëmijë, përjashtohet përgjithmonë nga të gjitha taksat. Tani, këto janë politika të cilat kanë një kosto financiare për çdo vend dhe pyetje që unë i drejtoj përfaqësuesve të qeverisë hungareze ishte: “Ju lutem, më thoni sa është fatura financiare, cili është borxhi publik që ju keni” dhe dëgjoj, përpara disa muajsh ishte kjo bisedë, që borxhi publik i Hungarisë ishte 72%. Dhe ngrita supet, nisa të shkruaj e të mbaj shënim, me habinë e madhe sesi është e mundur që një vend si Hungaria të ketë borxhin e vet publik 72%, ndërkohë që ofron të gjitha këto të mira dhe këto mundësi në raportin e dimensionit social për individin, çiftin, prokrijimin, lindshmërinë e fëmijëve dhe familjet, ndërkohë që vendi ynë Shqipëria borxhi publik i deklaruar, që dihet zyrtarisht, është 87% dhe jemi jashtëzakonisht shumë larg këtyre gjërave.”

Mendoj se asnjë ligj i vendit tim, apo ligj ndërkombëtar nuk më ndalon apo kufizon të drejtën time për të vlerësuar publikisht politikat të cilat janë në mbështetje të familjes nga vende si Hungaria, pjesë e Bashkimit Evropian, ku vendi ynë aspiron të bëhet anëtar. Në ankesën ndaj personit tim, paraqitur në institucionin tuaj nga drejtues të organizatës LGBTQ+ është lehtësisht e evidentueshme përpjekja e tyre për të imponuar ‘kulturën e ndalimit’. Sterotipizimet e shteteve si Hungaria, Çekia dhe Polonia, atashimi i tyre me “shkeljet flagrante që kanë kryer ndaj të drejtave të personave LGBTQ+” dhe krijimi i “një precedenti të rrezikshëm për ardhmërinë e Shqipërisë” vetëm se unë kam përmendur politikat fiskale në mbështetje të familjes dhe kam vlerësuar moralin dhe kulturën e këtyre vendeve, vendos ankesën ndaj personit tim ardhur në institucionin tuaj, në kufijtë e absurdit. Shpresoj që institucioni juaj të shqyrtojë ankesën ndaj personit tim dhe Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës në mënyrë racionale dhe të mos krijohen precedentë të kulturës së ndalimit si dhe sterotipizime që lidhen me shkelje të të drejtave të njeriut për vende si Hungaria, Çekia, Polonia, që gjithnjë kanë qenë dhe mbeten vende mike me Shqipërinë. Unë personalisht dhe Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës mbetemi të përkushtuar në punën tonë për ndërtimin e një shoqërie mbi strukturën e besimit, solidaritetit, drejtësisë sociale dhe vlerave të barabarta. Qëndrojmë në anë të institucioneve të Shtetit Shqiptar për të mbështetur përpjekjet për fuqizimin e familjes, mbrojtjen e fëmijëve, kurimin e plagëve të shoqërisë dhe minimizimin e faktorëve që lidhen me shpopullimin e vendit”.

5. Me shkresën nr. 205/3 prot., datë 13.03.2023, Komisioneri i përcolli A. G. një kopje të ankesës (nr. 22 Regj., datë 06.02.2023, të Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në

Shqipëri”) dhe dokumentacionin bashkëngjitur saj, si dhe kërkoi informacion dhe parashtrime sa i përket pretendimeve të ngritura në të nga ana e subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, A. G. nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion apo parashtrime lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

6. Në vijim të shqyrtimit të çështjes, me shkresën nr. 205/4 prot., datë 13.04.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua sërish A. G., duke kërkuar informacion dhe parashtrime sa i përket pretendimeve të ngritura në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, A. G. sërish nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion apo parashtrime lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

7. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 205/5 prot., datë 27.04.2023 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 09.05.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 09.05.2023, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit, me praninë e përfaqësueseve të palës ankuese: A. A., Drejtore Ekzekutive e Qendrës dhe av. S. K., me numër licence 10 419, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe përfaqësuesit të palës kundër të cilës është paraqitur ankesa, A. P., A. G. dhe av. E. A., me numër licence 6441, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor<sup>8</sup> të palëve ndaj të cilëve ishte paraqitur ankesa.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në deklaratimet e bëra gjatë seancës, të dyja palët mbajtën të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit.

Fillimisht nga palët në proces u sqarua fakti që Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, nuk është i regjistruar në organet gjyqësore dhe nuk ekziston si person juridik. Në këtë kuptim, procedura e shqyrtimit të ankesës do të vijojë kundër A. P. dhe A. G..

Gjithashtu, gjatë seancës përfaqësuesi ligjor i palëve ndaj të cilëve ishte paraqitur ankesa, braktisi klientët e tij, A. P. dhe A. G., dhe u largua nga seanca dëgjimore.

Në parashtrimet e bëra nga ana e A. P., theksohet ndër të tjera se: “...Është përgjegjësi e çdo pastori, e çdo kleriku, sikundër e çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë, që të japin kontributin e vet, të ndërtojë një shoqëri mbi perceptimin e drejtësisë sociale, shanseve të barabarta. Kur

---

<sup>8</sup> U deklarua nga palët gjatë seancës dëgjimore se E. A. do të ishte përfaqësuesi ligjor i tyre.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

flasim për normalitet, nuk flasim për anormalitet në dimensionin mendor, nuk po flasim për faktin që të njihen individët gay apo pjesë të grupit LGBT si anormalë. Po flasim mbi perceptimin e nocioneve normë dhe jo normë. Pra ajo që njihet dhe që është e pranuar nga shoqëria si normë, nga tradita, nga religjioni e të gjitha këto me radhë dhe ajo që nuk njihet si normë pra që nuk njihet si diçka e cila është një karakteristikë predominante në shoqëri...Absolutisht unë nuk i shikoj personat që janë pjesë e e komunitetit LGBT apo edhe ata të cilët nuk janë pjesë e një organizate LGBT, por që kanë një orientim ndryshe seksual, nuk i shikoj si njerëz jonormal. Çdo qenie njerëzore, çdo njeri është i krijuar nga zoti, ka vlerë, ka dinjitet dhe ne duhet të sigurohemi që ti hapim çdo qenie njerëzore, pavarësisht orientimit të tij gjinor dhe seksual, dinjitetin që ka me krijimin dhe unë kam qenë një nga individët që kam përshëndetur dhe e kam përqaftuar me të madhe në vitin 2010, kur është miratuar ligji kundër diskriminimit dhe jam përprjekur që në agonin e debatit publik, sa herë që më jepet mundësia për të folur për tematikat që ne jemi mbledhur sot së bashku, ku preket natyrisht edhe një komunitet apo një grup, i cili për hirë të të vërtetës në kulturën kombëtare, pjesë e të cilës jemi të gjithë, është përballur me mesazhe dhune, është përballur me mesazhe diskriminuese, është përballur me komente të cilat nuk i kanë dhënë dinjitet askujt, as atyre që i bëjnë këto komente dhe as atyre tek të cilët shkojnë këto komente. Pra kjo ishte në parashitë të time në mënyrë që një herë e përgjithmonë të kemi një perceptim të qartë mbi pozicionin tim dhe të miqve tanë që janë pjesë e Koalicionit Pro Familjes edhe Jetës, në raport me grupin LGBT. Nga ana tjetër kjo nuk do thotë që duhet të jemi dakord me çdo mendim të kauzës LGBT. Unë shikoj që edhe tek subjekti i cili ka parashtruar ankesën, vetë emërtesa e subjektit “Qendra e Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, vetë emërtesa e organizatës që ju përfaqësoni paraqet atë që unë kam thënë gjithmonë, hera herës, që ka një kauzë vetë tek emërtesa e subjektit tuaj, është termi apo nocioni kauzë. Pra organizimi i takimit tonë në datën 23 nëntor dhe bërja publike e mesazheve që janë përcjellë nga unë personalisht ka pasur vetëm këto synime. Synimi kryesor i yni ka qenë informacioni, informimi i prindërve mbi titullin e ndryshuar në përkthimin e titullit të filmit, në përkthimin shqip të filmit “Strange World”, në shqip është përkthyer “Botë e Mrekullueshme”, në anglisht është “Botë e Çuditshme”. Në shqip është sjellë bota e mrekullueshme. Kur ne hymë edhe pamë mbi reagimin dhe reaksionin që ka patur filmi në Amerikë, është një nga filmat që ka sjellë humbjet më të mëdha financiare në Hollivud, për shkak të kontetit që ka patur filmi dhe për shkak të reaksionit që ka sjellë në shoqërinë amerikane. Në shqip natyrisht nuk erdhi me origjinalitetin e titullit të vet, por erdhi një titull i tjetërsuar. Dhe kur ne flasim për shtigje të errëta, nuk flasim për shtigje të errëta që lidhen me idenë e identitetit gjinor, flasim për mungesën e informacionit, për publikun, për shoqërinë që i lë njerëzit në një lloj terri informativ. Pra, terri informativ apo mungesa e informacionit përdoret gjërësisht si koncept dhe si nocion në media, kudo, nuk është diçka që e kemi shpikur ne dhe unë po jua them këtu sot, në këtë ballafaqim përpara Komisionerit, që nuk ka lidhje me idenë e territ informativ apo mungesës së informacionit, nuk kuptojmë idenë e shtigjeve LGBT, por ideja që filmi vjen i tjetërsuar dhe tjetërsimi është tek titulli i filmit.

Më tej, gjithashtu në informimin e prindërve kemi synuar dhe të familjarëve të fëmijëve mbi tematikën dhe përmbajtjen e filmit, sepse nuk ka patur një informacion mbi kontentin që paraqet

filmi, edhe në kinema nuk ka pasur. Siç një libër ka një një hyrje apo tek kapaku i librit ka një përmbledhje të filmit, edhe tek një punim akademik ka një abstrakt që tregon se çfarë ndodh, nuk ka pasur informacion. Pra, hapi i informimit paraparak mbi përmbajtjen e filmit është parë i nevojshëm nisur nga dëshira e mirë për ti dhënë prindërve dhe familjarëve të fëmijëve që do të shikonin filmin, mundësinë e informacionit përpara zgjedhjes, alternativën informative, kjo ka qenë çështja e dytë.

Çështja e tretë, nga shqyrtimi i kujdesshëm i videos live që ne kemi pasur, për hir të vërtetës dhe nuk është ndjekur live nga 5000 njerëz, siç u tha, por kanë qenë 80 apo 100 apo 120 njerëz. Video më vonë ka akumuluar shikueshmëri për shkak të shpërndarjes por nuk ka pasur një shikueshmëri live 5000 njerëz. Që të kesh 5000 njerëz live në facebook në shikueshmëri do thotë që të kesh mbi një milion e ca ndjekës në facebook, kjo nuk është e vërtetë. Unë duke e parë dhe duke e transkriptuar komunikimin tim në video fjalë për fjalë nuk gjen asnjë moment evidenca që lidhen me fyerje apo diskriminim për shprehjet e një opinionit publik brenda lirisë së shprehjes dhe të fjalës, sepse mendoj që të komentosh mbi një film, të informosh mbi një film, të flasësh mbi përmbajtjen e një filmi, të sensibilizosh opinionin publik mbi një film dhe të shpalosës përmbajtjen e tij, nuk nuk mendoj që ka kontent diskriminues. Më tej, të konsumosh diskriminim, do të thotë të krijosh një pasojë që e pengon të diskriminuarin të trajtohet në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Në dijeninë time nuk ka një evidencë të pasojave të krijuara nga komunikimi im, jo nga komunikimi i komentuesve mbi komunikimin tim. Unë ndërsa komunikoj live nuk mund të kontrolloj dot komentet që njerëzit bëjnë në komunikimin tim publik. Ndërsa po flas, ndërsa komunikoj zakonisht kur unë bëj zakonisht një status, kur në statusin tim flas për martesën e një burri dhe një gruajë apo kur kemi folur edhe për çëshjet e mëparshme që ne kemi trajtuar bashkë ose e kam fshehur ose i kam fshirë mesazhet që kanë patur përmbajtje diskriminuese. Pra, gjithnjë jam i prirur që atë që jua thashë në hyrje të bisedës ta kemi si një model në komunikimin tonë...”.

Gjatë seancës, Komisioneri iu drejtua A. P. me disa pyetje lidhur me çështjen dhe parashtrimet e bëra më parë, si më poshtë:

- A është në dijeni që shtetet si Hungaria dhe Polonia, nga Bashkimi Evropian konsiderohen shtete, të cilat janë në shkelje të të drejtave të njeriut, sidomos të lirive individuale, për shkak të ndryshimeve të tyre Kushtetuese dhe ligjore, dhe aktualisht sot nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet raporteve dhe konstatimeve, janë konstatuar që janë shtete në shkelje të të drejtave të njeriut dhe sidomos të lirive individuale?
- A mendon se liria e shprehjes është e kufizueshme?
- Në takimin e datës 23 nëntor, janë thënë nga pjesëmarrës p.sh.: “ka një urgjencë se mund të dëmtojë shëndetin mendor, emocional dhe të ndikojë negativisht në shumë fëmijë”, “agjenda geje globaliste po përparon në dëm të familjes”, “transmetimi me përmbajtje LGBTI+ për fëmijë ishte i rrezikshëm për ta”, “ky komunitet i jep fëmijëve modele të shtrembëruara të cilat janë homoseksuale dhe shkaktojnë probleme të rënda psikike te fëmijët, siç i kemi parë edhe në vendet perëndimore”. Si pjesëmarrës në atë takim dhe nisur edhe nga parashtrësja, a mendon që deklarata të tilla, pavarësisht grupit shoqëror që i adresohen, janë etike, normale



për një diskurs publik dhe përçojnë mesazhet e duhura në publik? Nëse të njëjtat terma, do të përdoreshin kundrejt besimtarëve që përfaqëson, do të ishit dakord me këto lloj termash të përdorur për t'iu drejtuar një grupi shoqëror, pavarësisht cili grup shoqëror do të ishte? A do të ndjeheshit mirë, a do të ndjeheshit të shqetësuar nëse dikush do të përdorte të njëjtat terma kundrejt besimtarëve tuaj?

Lidhur me sa më sipër, A. P. sqaroi ndër të tjera se: *"...jam në dijeni për politikat fiskale pro familjes edhe për faktin që i kanë dhënë zgjidhje problematikave të mëdha, të cilat ne në Shqipëri ende rrekemi që t'i gjejmë zgjidhjet dhe i kam marrë si modele për të promovuar këtë dimension të këtyre vendeve. Dimensionin që natyrisht unë do ta promovoj sërish, nëse do me jepet mundësia, që nëse është e mundur për të ndihmuar çiftet e reja, për të ndërtuar një shtëpi, nëse është e mundur për të ndihmuar gratë shtatzëna, për t'u kujdesur për beben e tyre financiarisht. Pra, kjo ka qenë ideja. Nuk jam në dijeni të asnjë akti të formalizuar që mund të jenë marrë nga strukturat e Bashkimit Evropian, po kjo mund të jetë për fajin tim. Po nuk jam në dijeni.*

*Mendoj që për sa unë e perceptoj Kushtetutën, dy nga artikujt kryesorë të Kushtetutës, është liria e shprehjes edhe liria e besimit. Për aq kohë sa liria e shprehjes nuk përbën një precedent të rrezikshëm me pasoja të evidentueshme ndaj një individi apo ndaj një grupi shoqëror, natyrisht që nuk mund të ketë censurë ndaj lirisë së shprehjes...Pra, mund të jetë e kufizueshme.*

*Unë do të thoja që nga fillimi i narrativës time shpjeguese, nga fillimi deri deri në fund, nëse unë vetë do të kisha nënkuptuar diçka që lidhet me diskriminim apo me gjuhë urrejtje, natyrisht që do isha shprehur ndryshe, por për aq sa unë nuk jam shprehur ndryshe, jam shprehur në formë, siç ju e keni të shkruar edhe në video që jam shprehur. Nga ana tjetër mendoj që unë personalisht apo zoti A. G. nuk jemi përgjigjës për mënyrën se si çdo komentues apo edhe çdo individ rreth një tryeze mund të shprehet mbi një subjekt të caktuar. Pra, në këtë rast ne nuk kemi qenë aty për të nënshkruar një rezolutë...Pra, qëndrimet tona si Koalicion në tryezat tona, janë krejt të qarta në raport me dinjitetin njerëzor, në raport me luftën kundër diskriminimit që kemi për detyrë të gjithë, duke filluar nga unë i pari, të bëjmë, duke përzgjedhur një gjuhë komunikimi nderuese dhe vlerësuese, po natyrisht çështje të cilat ne kemi folur. Pra, unë nuk e di domethënë se sa do të isha i atashuar në mendimin tim në raport me citimet që individë të tjerë, që as s'e kam idenë kush janë tani nga këta që mund të kenë bërë këtë lloj komunikimi, por unë personalisht, në qoftë se do doja që të shprehja bindjen time në këtë formë, do ta kisha shprehur. Por, për shkak se bindja ime nuk është kjo dhe nuk shprehet në këtë formë, atëherë unë e kam zgjedhur fjalën si instrument me kujdes, pra në mënyrë të përkorë, për të shprehur gjërat që unë kam shprehur. Parimi universal që vjen nga perceptimi kristian i jetës dhe i botës është me nis nga vetja pra, bëj për tjetrin atë që do të doje që tjetri të bënte për ty. Kështu që, kurrsesi nuk do të donim që të ngarkonim një individ apo një komunitet apo një grup me një barrë që nuk meriton ta ketë mbi vete as emocionalisht, as për sa i takon idesë komentimeve që e bën publiku. Unë edhe në komunikimin tim në televizione e madje, kam bërë dhe thirrje pas çështjes së dytë, që ne e kemi pasur dhe vazhdojmë ta kemi të hapur në gjykatë, kam bërë thirrje në media që, sepse është para që çdoherë që ka një komunikim dhe në qendër të bisedës vendoset çështja e identitetit gjinor, trajtohet prindi një, prindi dy, trajtohet birësimi i fëmijëve nga prindër brenda të njëjtës gjini, është parë nga komentues, në kulturën shqiptare që ka tejkalime, nuk diskutohet, ka*

*tejkalime, ka gjuhë dhune, ka gjuhë urrejtje, ne distancohemi nga kjo gjë dhe unë dëshiroj t'ju garantoj që në dimensionin e luftës kundër diskriminimit, kisha, unë si individ jam serioz për të vijuar punën time si një aktivist në mbështetje të çdo qenie njerëzore që të mos diskriminohet. Kur them çdo qenie njerëzore, e them se po ta thoja duke ju shkëputur nga tërësia e të qenurit njeri, atëherë do të ndiheshit njëfarë mëyre jo të barabartë me pjesën tjetër... ”.*

Përfaqësuesja e Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, parashtrori ndër të tjera se: *“...Për sa i përket informacionit mbi kontentin e filmit, ne jemi shumë dakord që të kërkohet informacion mbi kontentin e tij, nuk jemi aspak kundra kësaj gjëje, por ajo çfarë na bën përshtypje është se, pse u bë kaq e madhe pikërisht në momentin që flitet që dy personazhe të filmit janë persona të cilët kanë marrëdhënie dashurie me njëri-tjetrin. Pse në momentet kur Borëbardha, që është produksion i Disney apo Hirushja, apo Bukuroshja e Fjetur zgjohen, sepse puthen nga princ e tjerë, pse në atë rast interesi më i lartë i fëmijës nuk është ai që të mos diskutohet në lidhje me atë që nuk është në përputhje me zhvillimin e tyre. Sepse në qoftë se një fëmijë i cili është i moshës 5, 6, 14 vjeç, sheh një film ku flitet në lidhje me marrëdhënie emocionale midis dy personave, pse në atë rast nuk është kërkuar që të ketë kontent dhe të ketë informacion në lidhje me kontentin e këtij filmi. Kjo është gjëja që ne na bën përshtypje, sepse u bë kaq e madhe, u bënë thirrje të tilla, me të tillë kontent që ne e lexuam disa herë dhe nuk do doja që ta lexoj asnjëherë tjetër të kërkohej ky informacion e të kërkohej që nga Kinema Millenium, që të mos transmetohej. Që më vonë, në fakt ndodhi edhe kështu, që nuk u transmetua, si shkak i protestave që u zhvilluan e tjerë e tjerë.*

*...seksualizmi është edhe në momentin që ne shohim Hirushen dhe Borbardhën që çohen nga gjumi nga puthja e një princi. Ne jemi shumë dakord që të merren këto informacione, por nuk jemi dakord që në interes të fëmijëve të bëhen tani këto interpretime nga persona të cilët nuk janë aspak përfaqësues ligjor.*

*Fëmijët, kanë përfaqësuesit ligjorë të tyre, që në shumicën e rasteve janë prindërit ose në të kundërt, persona të cilët vendosen nga institucionet përkatëse, nga gjykata... Janë të lutur që të thonë gjithmonë mendimin e tyre, bindjet e tyre, të djathta e tjerë e tjerë. Është shumë normale, e gjithë bota është në këtë konflikt. Nuk kemi aspak kundra, por që nuk kemi pse të marrim përsipër dhe të themi se si mund t'i përgjigjet një prind në momentin që sheh filmin Strange World. Prindi është ai që ushtron përgjegjësinë prindërore, është përfaqësuesi ligjor dhe do t'i japë përgjigjen në mënyrën e tij pa patur nevojë që të bëhen thirrje të tilla publike dhe të bëhen diskutime të tilla që po i mësohen fëmijëve që të jesh gay është normale, por në fakt nuk është e tillë...”*

Në vijim, A. G. referoi gjatë seancës ndër të tjera se: *“...Jam këtu në cilësinë e një personi që i është vënë gabim etiketimi i përfaqësimit, e shpjegova edhe në fillim, unë nuk jam përfaqësues i Koalicionit për Mbrojtjen e Familjes dhe Jetës...Elementi i dytë ka të bëjë me atë që quhet një ankesë që ka ardhë nga një organizatë, e cila, siç e kam cituar dhe në shkresën e parë që e kam drejtuar Komisionerit të nderuar, kam deklaruar që është një sajesë, montime fjalësh, fabrikime, montazhe, është një manipulim i plotë dhe mbi të gjitha ka kaluar vijën e kuqe nga çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, në çështjet e ndërhyrjes, në të drejtën për të pasur pikëpamje politike, siç është një nga elementet bazë që i garanton Kushtetuta dhe që*

është derdhur gjak për këtë punë kudo në botë, për të mbrojtur këto të drejta, që janë të drejtat e mendimit politik e qëndrimeve politike. Unë tani do të analizoj gjermë për gjermë, të gjitha manipulimet që janë përcaktuar në këtë tekst të shkruar në mënyrë skandaloze në aspektin e montimeve të fjalëve...Dhe unë kam një pyetje, duke filluar me fjalët e para.

1. Në cilën sekuencë, minutë dhe sekondë, pretendohet se unë kam thënë se, po të citoj tani: 'zoti A. G. u shpreh se ky film është një kurth, pasi kinemaja nuk u ofron informacione prindërve ndaj përmbajtjes së tij homoseksuale dhe se në Shqipëri ka ardhur momenti të shihet përmbajtja e filmave të shfaqur për fëmijët, pasi ato shfaqin persona LGBT'.

- Kur e kam thënë unë këtë perifraksim? Kurrë. Ky paragraf, siç është cituar, ky citat këtu është i sajuar, është i shpikur. Dhe unë prandaj kam pyetur në cilën minutë dhe sekondë, a e kemi ne të bëjmë me montime dhe fabrikime fjalësh dhe bashkime keqdashëse për të prodhuar pretendime të rreme.

- A kam thënë këto fjalë apo kam cituar një tekst të prodhuar nga media Pink News dhe çfarë them unë përveç saj?

- Pse është hequr ajo që kam thënë dhe pse është shtuar ajo që nuk kam thënë? Unë kam cituar pikë për pikë, tekst të përkthyer nga Google Translate publikisht, në lexim publik, çfarë ka thënë një media kryesore nga më të rëndësishmet, më prestigjiozet të komunitetit gay.

2. Në cilën sekuencë, minuta dhe sekonda, i referohet pretendimit se unë paskam thënë: 'po kështu u propozua marrja e masave për kontrollin e programacionit për fëmijë, që shfaq personat LGBTI: në televizion, mes takimeve të ndryshme me AMA apo bordin e informacionit të RTSH-së, kur kam thënë unë shfaq personazhe LGBTI'

- A mos kam thënë se, gjatë orëve që shfaqen programe për fëmijë, transmetohen filma ku shfaqen djem të vegjël që puthen në buzë? Këto janë fjalët e mia. I keni në video.

- A ka diferencë midis pretendimit për shfaqje të personazheve LGBTI dhe puthjes në buzë midis djemve të vegjël?

- Përse është hequr ajo që kam thënë dhe shtuar ajo që nuk kam thënë?

3. Në cilën sekuencë, minuta dhe sekonda, kur unë them që puthen në buzë fëmijë të vegjël. Kjo nuk do të thotë se ka personazhe LGBT në film. Në cilën sekuencë, minuta dhe sekonda, kam thënë se kishte plane për ndërhyrje në kurrikula mbi paraqitjen e temave LGBT dhe se agjenda Gej Globaliste po përparon në dëm të familjes dhe fëmijëve. Mos kam ngritur pyetje mbi një program të Fondacionit Soros, që nuk ka transparencë dhe po kërkoja transparencë, nëse ka kurrikula të panjohura nga prindërit, që do futen në shkolla, ndërsa referimi mbi përparimin e agjendave e të tjerë e të tjerë, a po i referohet asaj, apo asaj që ndodh në botë, dhe që po shfaqet në Shqipëri nëpërmjet filmimit të Disney-t, për të cilin po diskutoni. Pra, kur unë flas për agjenda, ti s'mund të ma marrësh mua të ma veshë ku të duash. Unë e kam thënë sipas një fjalie të qartë... -

*Përse janë shkëputur dy koncepte nga dy çështje të ndryshme dhe janë bashkuar duke montuar fraza për të shpikur fjali që nuk janë thënë?*

*- Pse duhej bërë ky montim dhe manipulim, pra për të kaluar atë që vjen nga Disney, në çështje lokale?*

*4. Në kërkesën e Komisionerit pretendohet se më tej A. G. u shpreh se: 'shfaqja e nesërme ka një urgjencë, sepse mund të dëmtojë shëndetin mendor, emocional dhe të ndikojë negativisht në shumë fëmijë'. Në momentin që djem, 10-12 vjeç, të pashoqëruar nga prindërit, shkojnë në kinema për të parë këtë film dhe ata do të vendosen përballë një situatë turbulluese, krejt të papritur dhe surprizë dhe krejt të papërgatitur të mësimi seksualizues, LGBT që e quani ju, a mund të ndodhë që ata të mbeten të çoroditur dhe të nisin të vënë në dyshim vetë seksualitetin e tyre, që sapo fillon, dhe raportin që kanë me shokët e tyre dhe a nuk krijon kjo shqetësime identitare, që edhe mund të kenë pasoja psikologjike?*

*- Po nëse janë të shoqëruar, pikërisht dhe prindi reagon në panik, i kapur në kurth nga ajo që sheh dhe nga pyetjet e fëmijës dhe kjo mund të sjellë edhe keqreagime të prindit, të papërgatitur, a ndikon kjo në shëndetin mendor dhe emocional të fëmijës? Pra shqetësimi është te prindi apo te fëmija? Prindi që shkon në kinema, dhjetë tituj të ketë, dhjetë tituj shkencorë të ketë, ku shkon për të parë një film me alien dhe i del që fëmija po habitet se po sheh 2 djem të vegjël, që e konsiderojnë veten të aftë për të rënë në dashuri me njëri-tjetrin, në sy të publikut për një spektakël heronjsh, në atë moment prindi fillon e çoroditet se çfarë do t'i thotë fëmijës dhe fëmija mund t'i bëjë ndonjë pyetje, prindi mund t'i fusë ndonjë përgjigje dhe fëmija mund të goditet emocionalisht.*

*Ne themi kush jeni ju që ua fusni prindërve dhe ua mbani sekret që t'ia edukoni ju fëmijët.*

*- Si ndikon ky ballafaqim i fëmijës në kontekstin e familjeve me karaktere të ndryshme kulturore dhe etike, me prindër të divorcuar apo të dhunshëm, të raporteve të ndryshme të komunikimit dhe referencave në komunikim, në një situatë si kjo në kinema, kur fëmija dhe prindi ndodhen bashkë? - A ndikon tek fëmijët mësimi seksualizues, domethënë homoseksual në këtë rast, dhe a ka rrezik që kjo të sjellë pasoja tek fëmijët?*

*- A ka psikologë që e pretendojnë këtë gjë? Çfarë mendimi, çfarë qëndrimi ka për ndikimin e seksualizimit dhe agjendave LGBT, një ndër kokat më të mëdha akademike në botë Jordan Petersen.*

*5. Në cilën sekuencë, minuta dhe sekonda, gjatë fjalës time i referohet paragrafit: 'Thirrjet e drejtuara nga Koalicioni Pro Familjes dhe Jetës, me deklaratën e zotit A. P. dhe zotit A. G., por dhe përfaqësuesve të tjerë, të cilët vetëm në bazë të provave që kemi bashkëlidhur kësaj ankese kanë ardhur minimalisht një audiencë prej rreth 8000 persona, kanë një karakter të pakontestueshëm përjashtues, denigrues, fyes, stigmatizues, si dhe stereotipizojnë negativisht individët dhe fëmijët LGBTI (një i mitur, LGBTI ishte dhe personazhi i filmit), si jonormale,*

*kundër vlerave morale të familjes, me një agjendë agresive dhe si persona e fëmijë me probleme të rënda psikike dhe të formimit”.*

*a- Në cilin moment të fjalës time përmenden fëmijët dhe individët LGBT?*

*b- Në filmin Strange World, a ka persona realë apo ata janë alienë në një planet tjetër, në një mjedisi krejt surreal dhe fantazist?*

*c- Në cilin moment kam denigruar, fyer, stigmatizuar dhe stereotipizuar negativisht ndonjë personazh në filmin me alienë?*

*d. Në cilin moment kam përmendur apo referuar mbi personazhe fëmijë me probleme të rënda psikike të formimit?*

*e. Nëse nuk e kam thënë, pse është shpikur kjo frazë?*

*6. Cilave fjalë dhe teksti u referohen këto dy paragrafe:*

*Këtë aksion, këto thirrje, si dhe materialet e shpërndara, gjerësisht në rrjete sociale dhe fizikisht afër ambienteve të Kinema Millenium, përmbajnë elemente të diskriminimit të drejtpërdrejtë, diskriminimit tërthortë, gjuhës së urrejtjes, nxitjes së ndihmës për diskriminim, udhëzimit për të diskriminuar, në kuptim të nenit 3 të LMD-së e ashtu me rradhë.*

*Thirrjet e sipërcituara nuk mund të konsiderohen të izoluar dhe as të justifikohen në kuadër të parashikimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në mbrotje të lirisë së shprehjes, pasi kanë të gjitha shanset të ndikojnë negativisht në perceptimin publik ndaj çështjeve LGBTI, duke nxitur portretizimin dhe shikimin e personave dhe fëmijëve LGBTI si jonormal, çka mund të rezultojë në rritjen e niveleve të diskriminimit në të ardhmen.*

*a. Përse nuk citohet teksti i materialeve të shpërndara?*

*b. Çfarë thotë teksti i tyre, që nuk citohen në asnjë rast?*

*c. Kush fëmijë (ankesa i referohet një koncepti që nuk ekziston në legjislacionin shqiptar si fëmijët LGBTI), po diskriminohen në një aksion që i referohet mbrojtjes së fëmijëve dhe si?*

*d. Cila është gjuha e urrejtjes ndaj tyre, përderisa ata nuk përmenden fare, pasi në asnjë rast nuk janë përmendur, pasi as unë e as të tjerë nuk e pranojmë se duhet përdorur termi fëmijë LGBTI, pasi nuk jam dakord që duhet ta përdorim këtë narrativë, pasi jam kundër seksualizimit të fëmijëve?*

*e. Si janë diskriminuar direkt, tërthortë, ndihmesës apo udhëzimit për diskriminim të të ashtuquajturve në thonjëza “fëmijë LGBTI”, (që nuk i njeh legjislacionin shqiptar e as në Konventën Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve, as në Kushtetutë, as në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve në as Kodin e Familjes, as Ligji për Mbrojtjen e kundër Diskriminimit) e për më pak cila është gjuha e urrjetjes kur në asnjë rast nuk është për këtë kategori të pretenduar? Me fjalë, jemi*



këtu për diçka që ne s'e kemi përmendur kurrë, sepse nuk e pranojmë se ekziston dhe as e kemi hapur si temë. Kemi kaluar anash.

f. A është “çështje LGBTI” shfaqja e filmave që kërkojnë pabesisht dhe fshehtësisht, duke krijuar kurthe sekrete, pa informuar prindërit t'u mësojnë fëmijëve të tyre që të jesh gay është mënyra më normale e mundshme apo është çështje e të drejtave ekskluzive e prindërve dhe e askujt tjetër? ,

g. A nuk është thënë nga unë tekstualisht që prindërit duhet të vendosin vetë nëse fëmija i tyre ta shohë apo jo atë film dhe askush s'ka të drejtë ti gjykojë ata të vendosin ta çojnë fëmijën e tyre ta shohi atë film?

h. Po për personat mbi 18 vjeç, a nuk kam thënë që kanë të drejtë të bëjnë ç'të duan, se i marrin vetë vendimet dhe s'ka të drejtë t'i gjykojë kush dhe ku qëndron diskriminimi apo gjuha e urrejtjes?

i. Mos është faji i fshehjes kurth të informacionit të mbajtur të fshehtë nga kinemaja ndaj prindërve që krijojnë shqetësim dhe jo atyre që e nxjerrin në dritë, që ishim ne?

j. Përse duhej mbajtur e fshehtë diçka që e diskutonte gjithë media në përfundim dhe vetë media Pink News e komunitetit LGBTI, e paraqiste si element agjende “mësim për fëmijët”, pra jo thjeshtë film, por ndikim, influencim social, psikologjik, kulturor, sepse ka të bëjë me fjalën mësim?

k. Duke iu referuar një diskutimi dhe reagimi në muajin nëntor 2022 dhe sot jemi në 9 maj 2023, si është rritur niveli i diskriminimit përgjatë gjashtë muajve nga ky reagim për mbrojtjen e fëmijëve nga ndikimi i agjendeve globaliste?

l. Çfarë ka ndodhur nga 23 nëntori 2022 e deri më sot që vërteton se është rritur niveli i diskriminimit dhe ndaj kujt konkretisht apo kemi të bëjmë me një pretendim krejt të rremë dhe të sajuar?

m. Cilat janë të dhënat e besueshme që vërtetojnë këtë pretendim?

7. Në lidhje me pretendimin se përmendja e ekzistencës së një agjende LGBTI, quhet gjuhë urrejtje, a nuk ka sot referenca publike pa fund për këtë agjendë, sidomos nga Universiteti i Harvardit, i cili është dhe gjeneratori i gjithë politikave të Agjendës Soros për shpopullimin e Shqipërisë?

a. Mjafton të futesh në internet dhe të bësh kërkime dhe ka me qindra publikime të komunitetit LGBTI mbi ekzistencën e agjendës LGBTI. (për shembull <https://repository.gheli.harvard.edu/repository/12302/>). Dhe këtu kemi një dokument që është i prodhuar ndërkombëtarisht, që quhet Agjenda LGBTI 2030.

b. Mbi këtë agjendë ka folur edhe një ndër kokat e psikologjisë botërore, Jordan Peterson, në 2017 në BBC (<https://www.youtube.com/watch?v=aMcjxSThD54> një ndër intervistat më të

shikuara në botë, me 54 milionë shikime) dhe ai nuk ka pasur asnjë ndëshkim nga ndonjë komisioner apo gjykatë kundër diskriminimit për këtë intervistë.

c. Po ashtu gjykatësi i ndjerë i Gjykatës Supreme në SHBA, Antonin Scalia është shprehur me vendime të Gjykatës mbi Ekzistencën e Agjendës Homoseksuale Lawrence v. Texas, 539 U.S. 558 (2003) <https://caselaw.findlaw.com/court/us-supreme-court/539/558.html#dissent1>.

d. Aleanca për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, LGBT, ka publikuar agjendën e saj LGBT, <https://historiaime.al/wp-content/uploads/2020/10/SDG-Shqip-4.pdf>

e. Burime pa fund që flasin për ekzistencën e një agjende, përfshirë dhe përpjekjet për të futur në shkollat Shqiptare kurrikula apo aktivistë transgjiner (projekti drejtohej nga Xh. K.), brenda shkollave për të rekrutuar aktivistë adoleshentë pa lejen e prindërve, siç ka ndodhur vite më parë, në shkollën “Sami Frashëri” Tiranë, program i financuar nga jashtë me ndihmën e Bashkisë Tiranë të Erion Veliajt, në kuadër të kësaj agjende dhe që për fat u ndalua si pasojë e denoncimit tim mediatik në atë kohë.

8. Në lidhje me pretendimet se ajo ç’kam thonë nuk duhet të konsiderohet si e drejtë e lirisë së shprehjes, dua t’ju kujtoj se sot në Perëndim ka dy ideologji politike që konkurrojnë në nivel politik, social, kulturor dhe filozofik: Konservatorizmi dhe Leftizmi Liberal Globalist i Shoqërisë së Hapur. Në shumizma, por me rrënjë, në Fabianizmin që është e njëjta mitër ideologjike që polli Marksizmin dhe Fashizmin.

a. Pa dyshim që nga fillimi deri në fund si ankesa dhe pretendimet në kërkesën e Komisionerit reflektojnë qartësisht një pozicion Leftiz Globalist Liberal të Shoqërisë së Hapur, e cila është oponentja dhe antipodi i konservatorizmit. Kjo ankesë dhe kjo kërkesë referuar procedimit administrativ, fillon dhe mbaron si një përpjekje represive dhe totalitare e një qëndrimi politik liberal të shoqërisë së hapur, për të eliminuar qëndrimet e kundërta ideologjike, që në këtë rast është pozicioni politik ideologjik, social, kulturor, konservator. Unë i përkas këtij pozicioni. Legjislacioni për mbrojtjen kundër diskriminimit, por dhe Kushtetuta dhe Konventa e të Drejtave të Njeriut, më garanton mua mbrojtje ligjore kundër çdo persekutimi dhe detyrimi për të hequr dorë nga pozicioni im ideologjik, politik, social dhe kulturor, që ka të bëjë me besime të qartësisht politike, që jam konservator. Ky procedim, për shkak të njëanshmërisë ekstreme, duke u bazuar jo në logjikë, por thjesht në partishmëri ideologjike, i një pale, është veç një përpjekje, persekutimin e pozicionit të palës tjetër, sepse çështja e ndërhyrjes në domenin ekskluziv të prindit mbi mësimin e fëmijës dhe të qenit gay, si gjëja më normale e mundshme, pa lejen e prindit dhe në fshehtësi është një ndër çështjet më të debatueshme ideologjike dhe politike midis konservatorëve dhe liberalëve, midis republikanëve dhe demokratëve në SHBA. Rasti më i dukshëm i shtetit të Floridës dhe në Itali dhe kudo. Përdorimi i shtetit dhe pushtetit i një pozicioni të caktuar ideologjik, siç është edhe rasti i autorit të procedimit, Komisioneri, dhe shoqatave militante dhe para partizane, shoqatat LGBT, kundër aktivistëve politikë dhe fetarë konservatorë, siç jam unë dhe pastori i nderuar, A. P., në këtë rast është abuzim i rëndë dhe i papranueshëm i represionit totalitar, i një krahu politik dhe ideologjik, kundër krahut tjetër. Kjo sjellje cenon rëndë jo vetëm lirinë e shprehjes, por çdo liri dhe të drejtë që garanton Kushtetuta dhe KEDNJ...”

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga Komisioneri u kërkua që Qendra “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, të vendos në dispozicion të shqyrtimit të çështjes komentet që pretendohet se janë bërë nga individ të ndryshëm, gjatë dhe pas takimit të mbajtur nga Koalicioni Pro Familjes dhe Jetës më datë 23.11.2022.

8. Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri me anë të *e-mail*-it datë 09.05.2023, i përcolli A. P. dhe A. G., një kopje të procesverbalit të mbajtur të seancës.
9. Me anë të *e-mail*-eve datë 09.05.2023 dhe 10.05.2023, A. P. kërkoi nga Komisioneri që procesverbali i mbajtur me shkrim (dore) i seancës dëgjimore, ti dërgohet i zbardhur, si dhe t'i përcillet edhe një kopje e audio rregjistrimit të seancës.

Në përgjigje të *e-mail*-eve të sipërcituara, me *e-mail* datë 10.05.2023, Komisioneri i sqaroi A. P. se dokumenti i dërguar është i vetmi variant i shkruar që disponon. Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 205/7 prot., datë 17.05.2023, Komisioneri i vendosi në dispozicion 1 (një) kopje të CD-së së audio rregjistrimit të seancës dëgjimore të datës 09.05.2023.

10. Pas seancës dëgjimore nga ana e Qendrës “Të Bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”, u përcollën me anë të *e-mail*-it, datë 10.05.2023, komentet që pretendohet se janë bërë nga individ të ndryshëm, gjatë dhe pas takimit të mbajtur nga Koalicioni Pro Familjes dhe Jetës më datë 23.11.2022, si dhe u vunë në dispozicion parashtrime shtesë lidhur me çështjen, si më poshtë:

*“...Në seancën dëgjimore u theksua nevoja e identifikimit të llojeve të diskriminimit të pretenduara ndaj përfaqësuesve A. P. dhe A. G. dhe lidhjet e këtyre formave të diskriminimit me secilën nga sjelljet/deklaratat e tyre:*

- *Pretendojmë se deklaratat e A. P. dhe A. G. gjatë mbledhjes së datës 23/11 dhe thirrjet përgjatë aksionit të mbajtur në emër të Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës, të datës 24/11, të transmetuara publikisht mes medias dhe rrjeteve sociale në kuadër të këtij aksioni përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë. “Kjo mbledhje ka qëllim mbrojtjen e jetës, vlerave, identitetit të fëmijëve përballë komunitetit gej; komuniteti LGBTI ka një projekt për dëxhenderizimin e shoqërisë; axhenda agresive gej; axhenda gej është një regres i madh shpirtëror e njerëzor; filmi u mëson fëmijëve se dy djem apo vajza që nisin një romancë me njëri tjetrin janë normalë; shfaqja e një filmi me përmbajtje homoseksuale mund të dëmtojë shëndetin emocional e mendor dhe të ndikojë negativisht në shumë fëmijë”, ishin disa nga deklaratat e bëra nga A. G. dhe A. P. në mbledhjen e shfaqur live, për më tepër se 5600 ndjekës. Në aksionin e datës 24/11, mbajtur përpara Kinema Millenium, ku nga folës të ndryshëm u theksua mbajtja e aksionit në vijim të mbledhjes së një dite më parë dhe të Koalicionit Pro Familjes, u theksua se komuniteti LGBTI “filloi me prindin 1 dhe 2, vijoi me projektin për futjen në kurrikula shkollore të mësimëve homoseksuale dhe sot po del në një pikë akoma më sensitive”, “ky komunitet u jep fëmijëve modele të shtrembëruara, të cilat janë homoseksualë dhe shkaktajnë probleme të rënda psikike te fëmijët, siç i kemi parë në vendet perëndimore”,*

*“u tregohet fëmijëve se të jesh homoseksual është normale”. Këto thirrje përdoren nga A. G., A. P. dhe përfaqësues të tjerë që folën në emër të aksionit të organizuar nga Koalicioni Pro Familjes, duke portretizuar e trajtuar në mënyrë më pak të favorshme personat dhe komunitetet LGBTI përballë pjesës tjetër “normale” të shoqërisë në një situatë të njëjtë a të ngjashme (shumë filma vizatimorë portretizojnë personazhe heteroseksuale, por përmbajtja e tyre nuk ka qenë asnjëherë objekt i thirrjeve të ngjashme nga A. G. e A. P.), bazuar në shkaqet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të cilat theksohen në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 si shkaqe të mbrojtura, prandaj pretendojmë se janë drejtpërdrejtë diskriminuese ndaj personave dhe komuniteteve LGBTI në raport me pjesën tjetër të shoqërisë. Pas këtyre thirrjeve qëndron vazhdimisht elementi dhe konotacioni krahasimor mes komunitetit LGBTI si “anormalja, antivlera, shpopullimi, zhbërja e identitetit të fëmijëve” dhe pjesës tjetër të shoqërisë si “normalja, vlera, ruajtja e familjes dhe identitetit të fëmijëve, prokrijimi”.*

- *Të gjitha këto deklarata e thirrje të cituara më sipër i konsiderojmë se përmbajnë elemente të gjuhës së urrejtjes si një formë e shprehjes në publik, me mjete të ndryshme, që promovojnë e kanë potencial të nxisin denigrimin, urrejtje, të shqetësojnë, fyejnë, stereotipizojnë negativisht, e stigmatizojnë individët dhe komunitetet LGBTI mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.*
- *Si rezultat i shpërndarjes masive të këtyre thirrjeve në rrjetet sociale ka nisur një dizinformim publik, i bazuar në këtë qasje diskriminuese e stereotipizuese ndaj komunitetit LGBTI, si një komunitet vlerat e të cilit shkojnë përkundër rritjes së shëndetshme e zhvillimit të fëmijëve dhe familjes shqiptare. Për shkak të këtij dizinformimi komentet që përmbajnë kërcënime dhe gjuhë diskriminuese e urrejtjeje janë përhapur në masë në rrjet. Disa nga këto komente gjenden bashkëlidhur këtij parashtrimi, në cilësinë e provave shtesë. Këto thirrje e deklarata të mbajtura publikisht, që arrijnë më shumë se 12000 persona krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj komuniteteve vulnerabël LGBTI në krahasim me pjesën tjetër të shoqërisë, rrisin ekspozimin e këtyre komuniteteve ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë krahasuar me personat e tjerë jo LGBTI në rrethana të njëjta ose të ngjashme dhe prandaj e konsiderojmë diskriminim në kuadër të nenit 7/1 të ligjit nr. 10221/2010.*
- *Publikimin e gjerë online dhe shpërndarjen fizike të thirrjes së mëposhtme, e konsiderojmë edhe reklamë diskriminuese në kuadër të nenit 8 të të njëjtit ligj si një njoftim që paraqet, haptazi qëllim për të diskriminuar, për shkaqet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, publikimi i së cilës ndalohet në kuadër të ligjit.*

*Gjatë diskutimeve, përmendet se mbledhja kishte për qëllim informimin e gjerë të publikut, të mbronte të drejtat ligjore, jetën dhe familjen. Gjithashtu u përmendën hapat që koalicioni do të ndërmerre në një mënyrë “jo-diskriminuese” për të vendosur disa pika mbi “i”, duke bërë qëndresë ngjashëm me vende si Hungaria e Çekia, që kanë politika prezente që nuk nxisin shpopullimin, por prokrijimin. Këto deklarata nuk përmendin shprehimisht komunitetin LGBTI dhe në dukje mund të tingëllojnë të paanshme, por kuptimi i tyre mbart stereotipizimin, qëllimin diskriminues dhe trajtimin më pak të favorshëm të komuniteteve LGBTI në raport me pjesën tjetër të shoqërisë dhe praktikën e vendeve si Hungaria e Çekia. Në seancë u theksua nga A. P. se këto vende ishin referuar vetëm sa u përket politikave të tyre fiskale, mirëpo nga fjalimi i tij i plotë nuk*

rezulton kështu, pasi këto vende, ndaj të cilave ka aktualisht në fuqi masa ligjore të ndërmarra nga Komisioni European për shkak të shkeljeve flagrante që kanë kryer ndaj të drejtave të personave LGBTI+<sup>9</sup>, janë cituar nga A. P. si pika referimi për Koalicionin Pro Familjes e si shembuj avangardë në mbrojtje të familjes dhe gjinisë.

Gjatë takimit, A. G. shpjegoi se mbledhja kishte për qëllim informimin e gjerë të publikut, të mbronte të drejtat ligjore, jetën dhe familjen. U ftuan pjesëmarrësit që në datën 24/11/2022 t'i bashkoheshin koalicionit në shpërndarjen e informacionit mbi filmin (thirrja e mësipërme, e cila pretendojmë se përmban elementet e një reklame diskriminuese) si dhe u njoftua se do t'i shkruhej një letër Kinemasë "Millenium". A. G. u shpreh se do t'i drejtoheshin kinemasë për ta njoftuar për bojkotin e këtij filmi dhe se do t'i jepnin 24 orë kohë, ku nëse nuk e bllokoi shfaqjen e këtij filmi, do ta bojkotonin pa afat Kinemanë në fjalë, me synimin që të kishin "një ndikim"<sup>10</sup> te Kinemaja. Të nesërmen u njoftuam 5 minuta përpara shfaqjes së lajmëruar të filmit nga Kinema Millenium se shfaqja e filmit ishte anuluar dhe nga stafi i kinemasë na u dhanë arsye kontradiktore, të cilat i kemi adresuar në një ankesë tjetër drejtuar KMD-së. Thirrjet me bazë gjuhë diskriminuese e urrejtjeje ndaj komunitetit LGBTI të A. G. ndaj filmit Strange World, lajmërimi i dërgimit të kërkesës së shkruar ndaj kinemasë për anulim të shfaqjes së filmit pranuar publikisht gjatë mbledhjes së datës 23, thirrja për bojkot në rast se filmi nuk anulohet, në lidhje me faktin se filmi u anulua pa njoftim paraprak nga kinemaja fill pas aksioneve të Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës, ne kemi një dyshim të arsyeshëm e të bazuar t'i konsiderojmë si nxitje për diskriminim, pasi thirjet e Koalicionit në fjalë mund të kanë qenë të asaj natyre dhe intensiteti sa të mund ta kenë ndikuar marrjen e këtij vendimi diskriminues ndaj përmbajtjes LGBTI të filmit dhe komuniteteve LGBTI nga Kinema Millenium.

Po kështu këto thirrje e aksione të ndërmarra (kërkesa për anulim të shfaqjes së filmit; thirrja për bojkot të kinemasë nëse filmi nuk anulohet) i konsiderojmë udhëzimi për diskriminim si një kërkesë e hapur ndaj Kinema Millenium, për të diskriminuar përmbajtjen dhe personat LGBTI, në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, mes anulimit të shfaqjes së filmit.

Në kuadër të pretendimeve të shfaqura gjatë seancës dëgjimore nga A. P. dhe A. G., asnjë nga aktet dhe thirrjet që kemi parashtruar në këtë ankesë nuk i konsiderojmë brenda objektit të së drejtës për liri të shprehjes, por si gjuhë urrejtjeje e diskriminim të pastër referuar jurisprudencës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në bazë të nenit 10 të KEDNJ-së (e aplikueshme brenda juridiksionit shqiptar) në çështjet Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ebakan kundër Turqisë dhe Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë. Vlerat e demokracisë si toleranca dhe respekti ndaj dinjitetit të barabartë të çdo qenieje njerëzore kërkojnë kufizimin e lirisë së shprehjes sa herë është e nevojshme në një shoqëri demokratike, e sidomos për të ndaluar apo parandaluar të gjitha format e shprehjes që shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtje bazuar në mungesën e tolerancës dhe që shkaktojnë ofendime apo shqetësim ndaj grupimeve të caktuara të shoqërisë<sup>11</sup>. Në Vejdeland, GJEDNJ është shprehur se shtetet anëtare të KEDNJ-së duhet të tregoheshin të kujdesshme në kufizimin e arsyeshem të lirisë së

<sup>9</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_21\\_3668](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_21_3668)

<sup>10</sup> Minuta 27-28.

<sup>11</sup> [https://www.echr.coe.int/documents/fs\\_hate\\_speech\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/fs_hate_speech_eng.pdf)



shprehjes për të parandaluar deklaratat “fyese të pajustificuara” dhe diskriminimin kundrejt një grupi të caktuar, mes kryerjes së një testi që paraqet një prag edhe më të ulët se “gjuha e urrejtjes”<sup>12</sup>.

*Subjektet e prekura:*

Në seancën degjimore A. G. dhe A. P. drejtuan vazhdimisht pyetjen se mbi kë rëndonte diskriminimi i pretenduar nga ankuesi. E cilësojmë me rëndësi specifike të qartësojmë sërish, se pretendimet tona për diskriminim lidhen në mënyrë të përgjithshme me komunitetet LGBTI, të cilët janë vendosur në pozita stigmatizimi, stereotipizimi negativ, fyerjeje, denigrimi dhe kanë qenë subjekt i gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes përdorur nga A. G., A. P. dhe përfaqësuesit e Koalicionit Pro Familjes gjatë mbledhjes së datës 23 dhe aksionit të datës 24, si dhe gjuhës së urrejtjes të përhapur në rrjetet e media duke shërbyer si nxitje për publikun e gjerë. Të gjitha reagimet në rrjet, vijnë fill pas publikimit të mbledhjes së Koalicionit Pro Familjes, deklaratave e thirrjeve të drejtuara nga A. G., A. P. dhe përfaqësues të Koalicionit Pro Familjes që portretizojnë me gjuhë diskriminuese e urrejtjeje komunitetet LGBTI, duke i vendosur në pozitë të vështirë e më pak të favorshme në raport me anëtarët jo LGBTI të shoqërisë në situatë të ngjashme (të portretizuar nga një film për fëmijë me përmbajtje heteroseksuale).

Edhe pse në ankesën tonë nuk kemi specifikuar në asnjë moment se pretendojmë ekskluzivisht diskriminim ndaj fëmijëve LGBTI (janë përmendur në ankesë, pasi personazhi i filmit ishte një i mitur LGBTI), vazhdimisht gjatë seancës degjimore, A. G. dhe A. P. u shprehën se nuk ka fëmijë LGBTI dhe se ky koncept nuk mbrohet në legjislacionin shqiptar, pasi në të kundërt do të përfaqësonte një seksualizim të fëmijëve, çka e cilësuan një përpjekje e shprehje tjetër të rrezikshme të axhendës agresive gej. Në fakt, mbrojtja e fëmijëve LGBTI është një realitet në kuadër të sistemit të Këshillit të Europës, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria. Diskriminimi mbi baza të orientimit seksual dhe identiteti gjinor është shprehimisht i ndaluar në kuadër të të gjitha standardeve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve brenda Këshillit të Europës, çka faktohet dhe në link-un zyrtar të CoE, referuar në vijim<sup>13</sup>.

Në parashtrimet e A. G. u theksua se fjalët e cituara nga ankuesi në ankesën nr. 22 Regj. nuk ishin vetëm të montuara dhe jashtë kontekstit, por nuk ishin thënë fare dhe në asnjë lloj konteksti nga A. G., i cili kërkoi të saktësohen minutat gjatë transmetimit të mbledhjes live ku është shprehur me fjalët e cituara në ankesë:

Në tekstin original të ankesës nr. 22 Regj., jemi treguar të kujdesshëm të referojmë minutat e kryerjes së deklaratave të cituara, të cilat janë lehtësisht të provueshme pas një dëgjimi të thjeshtë të regjistrimit të mbledhjes, e cila deri para pak ditësh ishte e publikuar online. Ditën e sotme vumë re se regjistrimi i mbledhjes është fshirë nga administruesit e faqes së Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës, në rrjetin social Facebook. Për t'u përgjigjur në mënyrë edhe më të hollësishme lidhur me minutat e kësaj mbledhjeje dhe faktimit të deklaratave në fjalët e A. G. dhe

<sup>12</sup> [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-109046%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-109046%22]})

<sup>13</sup> <https://www.coe.int/en/web/children/lgbti-children>

A. P., do të na duhet vendosja në dispozicion e një kopjeje të regjistrimit të kësaj mbledhjeje nga KMD, në rast se disponohet. Në të kundërt, kërkojmë vendosjen në dispozicion të regjistrimit nga përfaqësues të Koalicionit Pro Familjes dhe Jetës, ndaj nesh dhe KMD-së, pasi ky regjistrim është i një rëndësie kritike për këtë vendimmarrje.

Pavarësisht pohimit të A. G. në seancë dëgjimore, se asnjë nga citimet tona nuk ishin fjalë të thëna prej tij dhe A. P., duke qenë se prezenca e deklaratave është lehtësisht e verifikueshme, nëse në vijim do të ketë pretendime se fjalët janë nxjerrë nga konteksti apo janë montuar në një mënyrë të tillë që të krijojnë përshtypjen e gabuar, shprehjet “axhendë agresive; regres; ndikim negativ në shëndetin mendor dhe emocional të fëmijëve; duan t’u mësojnë fëmijëve se romaca mes dy djemve ose dy vajzave është normale; axhenda gej globaliste po përparon në dëm të familjes dhe fëmijëve etj.” Pavarësisht kontekstit, mbeten deklaratat negative, me përmbajtje diskriminuese, fyese, denigruese, stereotipizuese e nxisin urrejtje ndaj komuniteteve LGBTI.

Pas vendosjes në dispozicion të regjistrimit të mbledhjes, jemi të gatshëm të faktojmë me minutat përkatëse çdo citim të përfshirë në ankesë, mes materialeve shtesë të shkruara apo mes paraqitjes së këtyre fakteve në një seancë tjetër dëgjimore.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. shqyrtimin e kujdesshëm të pretendimeve dhe provave paraqitur në kuadër të ankesës nr. 22 Regj. dhe këtij parashtrimi shtesë nga institucioni i Komisionerit;
2. marrjen e një vendimi të drejtë që tregon kujdes të veçantë në konsiderimin e raportit të hollë mes lirisë së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, vlerësimin e veçantë të pretendimeve dhe fakteve të paraqitura në kuadër të çdo forme të pretenduar të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, nxitjes dhe udhëzimit për të diskriminuar, në funksion të shmangies dhe parandalimit të praktikave të rrezikshme për demokracinë dhe të drejtat e njeriut e Shqipëri.”

11. Përsa më sipër, me anë të e-mailit datë 27.07.2023, Komisioneri i përcolli për dijeni A. P. dhe A. G.<sup>14</sup>, pretendimet e ngritura pas seancës nga ana e Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, si dhe kërkoi parashtrime shtesë nëse do të shihej e arsyeshme prej tyre.

Në përgjigje të e-mail-it të sipërcituar nga ana e A. P., me e-mail datë 04.08.2023 u theksua se i qëndron parashtrimeve të paraqitura më parë dhe nuk ka asnjë informacion shtesë për të referuar. Ndërsa A. G. nuk iu përgjigj e-mail-it të sipërcituar.

### III. Legjislacioni i zbatueshëm.

<sup>14</sup> Dërguar e-mail A. G. në adresën e e-mail-it të vënë në dispozicion prej tij, gjatë komunikimeve shkresore të mbajtura me KMD (zarfi i dërguar prej tij më datë 06.03.2023, protokolluar pranë KMD me nr. 205/2 prot., datë 08.03.2023).

Gjithkush është i ndërgjegjshëm mbi faktin se liria e fjalës dhe e shprehjes konsiston në një të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë luan rol thelbësor edhe në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Koncepti i qytetarisë dhe i pluralizmit janë të porealizueshëm, nëse individëve nuk u jepet mundësia e shprehjes së lirë të mendimit. Toleranca ndaj mendimit të tjetrit dhe të ndryshmit, mundëson bashkëekzistencën në shoqëritë bashkëkohore multikulturore.

Pavarësisht sa më sipër, liria e shprehjes mund të keqpërdoret në situata të caktuara, duke sjellë si pasojë shkeljen e të drejtave të personave të tjerë. Në emër të “lirisë së shprehjes”, individë dhe grupe të caktuara mund të shprehin ide për superioritet të një race, feje apo etnie të caktuar, me qëllim përçmimin e të gjithë atyre, që nuk i takojnë grupit “të tyre”, si dhe të bëjnë thirrje për ndjekje, izolim, po madje edhe deri për genocid ndaj tyre. Në raste të tilla, liria e shprehjes përbën shqetësim për kategori të caktuara individësh dhe shpesh kalon deri në gjuhë urrejtjeje ndaj tyre. Pikërisht, femoneme të tilla aktualizojnë diskutimin për lirinë e shprehjes, kufizimet e saj dhe keqpërdorimin e kësaj lirie.

Në mediat shqiptare, jo në pak raste, është konstatuar se kultura e fjalës së përdorur nuk është e duhura. Njëkohësisht, është vënë re se, jo në pak raste jemi ndeshur me fenomenin e nxitjes, përdorimit dhe përhapjes së “gjuhës së urrejtjes” në publik për kategori apo pakica kombëtare, pa reflektuar asnjë ndjenjë përgjegjësie për fjalën e thënë në median e shkruar dhe atë televizive.

Liria e shprehjes buron nga parashikimet përkatëse në aktet juridike ndërkombëtare dhe standardet minimale të saj rezultojnë të përcaktuara në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në nivel të përgjithshëm ndërkombëtar dhe në nivel rajonal. Shtetet palë e kanë për detyrë t'i inkorporojnë të drejtat dhe liritë në legjislacionin vendas dhe, në rast të cenimit të tyre, të mundësojnë mjete juridike për të rivendosur të drejtat e shkeluara.

Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë logjike edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

KEDNJ është forma më e rëndësishme e shprehjes së angazhimit të shteteve anëtare të Këshillit të Europës për vlerat e demokracisë, paqes dhe drejtësisë dhe nëpërmjet tyre, për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve që jetojnë në këto shoqëri. Kjo Konventë përmban parashikime të rëndësishme mbi lirinë e shprehjes, ku përveç mbrojtjes që i siguron kësaj të drejte, përcakton edhe kufizimet përkatëse.

Për sa më sipër, në Nenin 10, të KEDNJ-së parashikohet shprehimisht:

*“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa*

*marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive.*

*2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

Në paragrafin e parë të këtij neni përkufizohen të drejtat e mbrojtura, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij, përcaktohen rrethanat në të cilat një shtet në mënyrë të legjitimuar mund të ndërhyjë tek ushtrimi i lirisë së shprehjes. Për më tepër, neni 10 i KEDNJ-së, mbron jo vetëm përmbajtjen e informacionit dhe ideve, por edhe formën në të cilën janë shprehur ato. Kështu, dokumentet e shkruara, transmetimet në radio dhe televizione, pikturat, filmat, apo edhe sistemet e informacionit elektronik janë gjithashtu të mbrojtura sipas këtij neni. Për pasojë, mjetet e prodhimit dhe komunikimit, transmetimit ose shpërndarjes së informacionit dhe ideve mbulohen gjithashtu nga neni 10, i KEDNJ dhe institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zhvillimet e shpejta teknologjike dhe mënyrës se si liria e shprehjes mund të ndahet nëpërmjet mënyrave të tilla.

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku<sup>15</sup>:

1. ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....”<sup>16</sup>

Më tej, Gjykata ka garantuar lirinë e medias duke u shprehur në mënyrë të përsëritur se: “...kërkesa e përgjithshme që gazetarët të distancohen sistematikisht dhe formalisht nga përmbajtja e një citimi që mund të çojë në fyerje apo provokim të të tjerëve, apo të dëmtojë

<sup>15</sup> Carss-Frisk, M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane – Liria e Shprehjes;

<sup>16</sup> Për më shumë informacion referoju çështjes *Engels and Others kundër Hollandës*, 1976.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*reputacionin e tyre nuk pajtohet me rolin e shtypit për të ofruar informacion mbi çështjet e ditës, opinionet dhe idetë”<sup>17</sup>.*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se liria e shprehjes, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, qëndrojnë në themel të shtetit tonë. Kushtetuta, sanksionon detyrimin e shtetit, jo vetëm të mos i cënojë ato, por të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22, pika 1, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>18</sup> ku parashikohet shprehimisht: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*. Megjithatë, Komisioneri thekson sërish faktin se liria e shprehjes nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve. Në bazë të nenit 17, Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Parashikimi i saj sqaron se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”* Në këtë kontekst, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu, neni 18 i Kushtetutës parashikon se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”*.

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:**

Në nenin 9, *“Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë”*, citohet se: *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve. 2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për*

<sup>17</sup> Thoma kundër Luksemburgut,/64; Albert-Engelmann-Gesellschaft mbH kundër Austrisë

<sup>18</sup> Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*;

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodë Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



*mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.”*

Në nenin 14, ku parashikohet “Ndalimi i diskriminimit”, citohet se: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Neni 17, “Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave”: “Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë”.

Protokolli Nr. 12, në nenin 1 “Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”, citon: “1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër. 2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”.

### **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, ka përcaktuar sa më poshtë vijon në nenet respektive:**

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, referon në nenin 2 se: “1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.”

Në nenin 5, parashikohet se: “1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt...”.

Neni 18 , thekson: “1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit. 2. Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij. 3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive

dhe të drejtave themelore të të tjerëve. 4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Neni 19, parashikon: “1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. 2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. 3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t’u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme: (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik”.

Neni 20, parashikon: “1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohet me ligj. 2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj”.

Ndërsa Neni 26, parashikon: “Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër”.

### **Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcakton:**

Në nenin 3, parashikohen përkufizimet, duke parashikuar se:

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga 3 një synim i

ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Neni 5, citon se: “1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

**Akte dhe dokumenta të tjerë në kuadër të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, parashtrihen si më poshtë:**

- **Rekomandimi nr. R(97) 20 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për “Gjuhën e urrejtjes” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 tetor 1997 në takimin e 607-të të Zëvendës Ministrave):**

Termi “gjuhë urrejtjeje” do të kuptohet si mbulim i të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësi kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.”

- **Rekomandimi CM/Rek(2010)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 31 mars 2010 në takimin e 1081-të të Zëvendës Ministrave):**

Komiteti i Ministrave, në përputhje me parashikimin e nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Ministrave,

Duke ditur se lesbiket, homoseksualët, biseksualët dhe transeksualët kanë qenë për shekuj me radhë dhe vazhdojnë ende të jenë objekt homofobie, transfobie dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit edhe brenda familjes së tyre, duke përfshirë kriminalizimin,

marxhinalizimin dhe dhunën, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, dhe duke pranuar se nevojiten masa specifike për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave;

.....

Duke pasur parasysh se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë “Gjykata”) dhe juridiksione të tjera ndërkombëtare të cilat e konsiderojnë orientimin seksual shkak të ndaluar për diskriminim dhe të cilat kanë kontribuar për çuarjen përpara të mbrojtjes së të drejtave të personave transeksualë;

.....

Duke kujtuar që në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës, çdo dallim në trajtim në mënyrë që të mos jetë diskriminues, duhet të ketë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të përdorë instrumente që janë përpjesëtimisht të arsyeshme me qëllimin e ndjekur;

.....

Duke mbajtur parasysh se as parimi i vlerave kulturore, tradicionale ose fetare, dhe as rregullat e një “kulture dominuese” nuk mund të përdoren si shkaqe për justifikimin e fjalimeve të urrejtjes apo të asnjë forme tjetër diskriminimi, duke përfshirë dhe orientimin seksual ose identitetin gjinor;

.....

U rekomandon shteteve anëtare:

I. E drejta për të jetuar, për siguri dhe mbrojtje nga dhuna

B. “Fjalimet e urrejtjes”

6. Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes të cilat mund të kuptohen në mënyrë të arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. “Fjalimet e urrejtjes” ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe me jurisprudencën e Gjykatës.

- **Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022 në sesionin e 132):**

Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

....

Organizatat e shoqërisë civile duhet të inkurajohen të krijojnë politika specifike për të parandaluar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes dhe, kur është e përshtatshme dhe e mundshme, të ofrojnë trajnime për stafin, anëtarët dhe vullnetarët e tyre. Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të inkurajohen që të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë mes tyre dhe me palët e tjera të interesuara për çështjet e gjuhës së urrejtjes.

**Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), ka dalë me rekomadimet si më poshtë:**

**- Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015:**

*Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, promovim apo nxitje në gfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës"1 , ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;*

....

*Duke pranuar që udhëheqësit politikë, fetarë dhe komunitarë, si dhe personalitete të tjera të jetës publike, kanë një përgjegjësi veçanërisht të rëndësishme në këtë drejtim për shkak të aftësisë për të ndikuar te një publik i gjerë;*

## **B. Përkufizime**

### **Terminologjia**

**7. Për qëllimet e këtij Rekomandimi, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:**

**a. "avokim"** lidhur me denigrimin, urrejtjen apo përgojimin nënkupton mbështetjen e shprehur, të qëllimshme dhe aktive për sjellje dhe qëndrime të tilla lidhur me një grup të caktuar personash;

**i. "identiteti gjinor"** nënkupton e përvojën e brendshme dhe individuale të gjinisë që çdo person ndjen së brendshmi, që mund të mos korrespondojë me gjininë e përcaktuar në lindje, përfshirë ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, ndryshimin e pamjes apo funksionit trupor me mënyra mjekësore, kirurgjikale, apo të tjera) si dhe forma të tjera të shprehjes së gjinisë, përfshirë veshjen, të folurit dhe manierizmat;

**g. "denigrim"** nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;

**m. "urrejtje"** nënkupton gjendjen mendore të karakterizuar nga emocione të forta dhe joracionale mllëfi, armiqësie dhe përçmimi ndaj grupit të shënjestruar.



*o. "homofobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjen apo frikën nga homoseksualiteti apo nga njerëzit që identifikohen apo perceptohen si biseksualë, homoseksualë, lesbikë apo transgjinatorë;*

*q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;*

*u. "stereotipizim negativ" nënkupton një opinion të përgjithshëm sikur një pjesëtar apo pjesëtarët e një grupi personash kanë karakteristika të caktuara, duke i vlerësuar me negativitet, pavarësisht karakteristikave të veçanta të pjesëtarit apo pjesëtarëve fjalë;*

*z. "orientim seksual" nënkupton kapacitetin e kujt do për tërheqje të thellë emocionale, simpatie dhe seksuale ndaj të tjerëve si dhe marrëdhëniet intime dhe seksuale me individë të një gjinie tjetër apo të së njëjtës gjini apo të më shumë se një gjinie*

*bb. "stigmatizim" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;*

*cc. "transfobi" nënkupton paragjykimet, urrejtjes apo frikën nga transeksualiteti apo personat transeksualë apo transgjinatorë, bazuar në shprehjen e identitetit të brendshëm gjinor të tyre;*

*ee. "përgojim" nënkupton kritikën abuzive ndaj një apo shumë personave lidhur me anëtarësinë e tyre në një grup të caktuar personash;*

*gg. "grupe vulnerabël" nënkupton ato grupe që janë veçanërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë sipas rrethanave kombëtare por që zakonisht janë azilkërkuesit dhe refugjatët, emigrantët dhe migrantët e tjerë, komuniteti i personave me ngjyrë dhe hebrenjve, myslimanët, romët / ciganët, pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore, si edhe personat LGBT; në veçanti, përfshin fëmijët dhe të rinjtë që u përkasin grupeve të tilla;*

**- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - Komenti i Përgjithshëm nr. 22: Neni 18 Liria e Mendimit, ndërgjegjja ose feja, miratuar në sesionin e dyzet e tetë të Komitetit të të Drejtave të Njeriut, më 30 korrik 1993:**

1. Në përputhje me nenin 20, asnjë manifestim i fesë ose besimit nuk mund të përbëjë propagandë për luftë ose mbrojtje të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Siç deklarohej nga Komiteti në komentimin e tij të përgjithshëm nr. 11 [19], shtetet palë janë të detyruara të nxjerrin ligje për të ndaluar akte të tilla.

**- Progres Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë 2021, publikuar në 19 tetor 2021.<sup>19</sup> Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut:**

*Rastet e agresionit fizik ndaj anëtarëve të komunitetit ende ndodhin dhe gjuha e urrejtjes vazhdon, veçanërisht në mediat sociale.*

*Ndërgjegjësimi publik dhe pranimi i personave LGBTIQ mbetet i ulët, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese vazhdojnë të jenë problem në media,*

<sup>19</sup> Faqe 34, e variantit në anglisht të Progres Raportit.

veçanërisht mediat online, dhe nga politikanët. Dhuna dhe diskriminimi ndaj pjesëtarëve të komunitetit është ende një fenomen shqetësues në vend.

- **Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), miratuar më 7 prill 2020<sup>20</sup>:**

*ECRI rekomandon që autoritetet të marrin frymëzim nga rekomandimi i Politikave të Përgjithshme Nr.15 i ECRI-t për luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë me forcë dhe publikisht incidente të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht kundër personave LGBTI dhe romë. Ata gjithashtu duhet të inkurajojnë figura të tjera publike të dënojnë veprime të tilla dhe të përfshihen në kundërpërgjigje.*

- **Raport “Mbi diskriminimin dhe dhunën ndaj individëve bazuar në orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”, të Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, viti 2015<sup>21</sup>**

*Një nga rekomandimet në këtë raport është ndalimi i nxitjes së urrejtjes dhe dhunës për shkaqe të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si dhe llogaridhënia e personave përgjegjës për gjuhën e urrejtjes.*

- **Raporti i Komisionit Evropian, për Shqipërinë, publikuar më datë 31.05.2023<sup>22</sup>:**

*Përshëndet planin e veprimit 2021-2027 për personat LGBTI në Shqipëri dhe bën thirrje për zbatimin e tij; përshëndet suksesin e paradës së 11-të të Krenarisë së Tiranës në 2022; u bën thirrje autoriteteve të miratojnë legjislacionin për njohjen e identitetit gjinor dhe partneriteteve dhe/ose martesave të të njëjtit seks; shpreh shqetësimin e tij serioz për diskriminimin ndaj personave LGBTIQ+ në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor, arsimin, drejtësinë, punësimin dhe strehimin; dënon rastet e agresionit fizik dhe gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBTIQ+;*

#### **IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.**

Rezulton se, më datë 23 nëntor 2022, Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, ka organizuar takimin për të diskutuar rreth shfaqjes së filmit “Strange World”, në Kinema Millenium më datë 24.11.2022. Nga pala ankuese, është pretenduar diskriminim kundër Koalicionit Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, përfaqësuar nga A. P. dhe A. G., për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Vlen të theksohet fakti që Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës, është një grupim individësh, që ka në përbërje persona juridik dhe fizik, të cilët janë mbledhur në mbrojtje të

<sup>20</sup> Faqe 17 e Raportit, në variantin e gjuhës shqipe.

<sup>21</sup> A/HRC/29/23, 4 maj 2015, pika 78.

<sup>22</sup> Faqe 13 e Raportit, përkthim i Komisionerit.

familjes dhe jetës, por nuk konstatohet që Koalicioni të jetë rregjistruar në organet gjyqësore dhe të ekzistojë si person juridik.

Për të vlerësuar legjitimitetin e tij, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë Kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik: “24. *Personat juridikë janë publikë dhe privatë.* 25. ***Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen.*** 26. ***Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji***”.

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se, Koalicioni Shqiptar Pro Familjes dhe Jetës nuk rezulton të ketë fituar personalitet juridik sipas formës së kërkuar nga legjislacioni i sipërcituar. Për këtë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vijoi shqyrtimin e ankesës kundër A. P. dhe A. G..

Sipas informacionit të dhënë nga palët, në profilin e *Facebook* të A. P., është transmetuar në kohë reale takimi i mbajtur. Ndër pjesëmarrësit në këtë takim kanë qenë vetë A. P. dhe A. G.. Sakaq, Komisioneri nuk arriti të administrojë në cilësinë e provës, videon e plotë të takimit të mbajtur më datë 23.11.2022, por u arrit të shkarkohej nga llogaria në *Facebook* e A. G., fjala e mbajtur prej tij në këtë takim.

Sa më lart, pala ankuese ka pretenduar se nga ana e A. P. dhe A. G., janë bërë thirrje në rrjetet sociale gjatë takimit të “Koalicionit Pro Jetës dhe Familjes”, ku janë shprehur se filmi që do të shfaqej ishte një kurth, pasi Kinemaja nuk u ofronte informacione prindërve mbi përmbajtjen e tij homoseksuale. Sakaq, përmes këtyre thirrjeve, A. P. dhe A. G., kanë vënë në pozita diskriminuese anëtarët e komunitetit LGBT, për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual<sup>23</sup>.

Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, neni 78 “Përdorimi i veprave për procedura gjyqësore, administrative dhe procedura të tjera zyrtare” parashikon se: “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen

---

<sup>23</sup> Referuar parashtrimeve të bëra nga subjekti ankues pas seancës dëgjimore, ku ka cituar vetëm shkakun e identitetit gjinor dhe atë të orientimit seksual.

*e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”.*

Në rastin konkret, institucioni i Komisionerit ka zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara jo vetëm në ligjin e tij rregullator, por dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 35/2016 “*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to*” dhe konkretisht nenit 78, sipas të cilit lejohen të riprodhohen pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative.

#### **A. Lidhur me shprehjet e përdorura nga A. P.**

Sa i përket pretendimeve të tyre, pala ankuese vuri në dispozicion të Komisionerit 2 (dy) “*linqe*” ku mund të aksesohet videoregjistrimi i takimit të “Koalicionit Pro Jetës dhe Familjes”, të datës 23.11.2022. Pavarësisht këtij fakti, Komisioneri nuk arriti të aksesojë videoregjistrimin e takimit, pasi “*linqet*” e vendosura në dispozicion nuk hapeshin, një fakt të tillë e ka pohuar edhe pala ankuese në *e-mail*-in e përcjell më datë 10.05.2023. Ato ishin fshirë nga interneti dhe nuk ishte i mundur aksesimi i tyre.

Në këto kushte, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të pretendimeve të paraqitura në ankesë, Komisioneri zhvilloi edhe një seancë dëgjimore. Pavarësisht kryerjes së seancës dëgjimore, nuk u arrit të sillej nga pala ankuese, dhe as të sigurohej nga institucioni, materiali filmik mbi të cilin të mund të bëhej një vlerësim në tërësinë e tij dhe nëse është përdorur apo jo gjuhë urrejtje. Në këto kushte, kur materiali nuk është i publikuar Komisioneri e ka të pamundur të gjykojë e të vlerësojë mbi një kontent që nuk ekziston.

Për sa kohë që, nuk u arrit të sigurohej informacioni dhe të administroheshin provat e nevojshme, Komisioneri është në pamundësi për t’u shprehur mbi pretendimet e ngritura nga pala ankuese kundër A. P. dhe për të vlerësuar nëse jemi përpara përdorimit të gjuhës së urrejtjes, në kuptim të ligjit. Në këto kushte, dhe bazuar në nenin 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative ku parashikohet se: “3. *Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*”, Komisioneri arrin në përfundimin se, për pjesën e ankesës që lidhet me pretendimet e ngritura kundër A. P., procedura administrative duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar<sup>24</sup>.

#### **B. Lidhur me shprehjet e përdorura nga A. G.**

---

<sup>24</sup> Vendime të ngjashme të Komisionerit: Vendimi nr. 56, datë 25.04.2019; vendimi nr. 94, datë 20.08.2020.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Gjithashtu, pavarësisht faktit që nga ana e palës ankuese nuk u vu në dispozicion të Komisionerit videoregjistrimi i aktivitetit të mbajtur më datë 23.11.2022, u arrit të administrohej në llogarinë e Facebook të A. G., fjala e mbajtur prej tij në këtë takim. Nga këqyrja e videoregjistrimit, evidentohet se A. G. është shprehur se: “...Jam shumë i gëzuar që jemi mbledhur prapë në një moment, kohë të papërshtatshme, sepse njoftimi është vetëm dje mbasdite, sepse takimi është urgjent për shkakun se nesër është një premierë e paparashikuar e një filmi që siç e tha pastori, kërkon të normalizojë ose më saktë të mësojë...do tregohem shumë korrekt me fjalët. Do ti referohem medias më të rëndësishme, që e keni aty të përkthyer totalisht, dhe referuar medias më të rëndësishme gej në botë “Pink News”, që e quan: Filmi i ri i Disney-t ‘Strange World’, u mëson fëmijëve të qenurit homoseksual është normale në mënyrën më të mirë. Ky është titulli i medias më serioze gej në botë. Unë kam këtu... printscreen-in e lajmit, ku dallohet qartë artikulli i Pink News, media më e madhe në botë e komunitetit LGBTQ. Siç lexohet edhe në tekstin e fundit, rreth Pink News, shpjegohet që kjo është media që mund ta quajmë si burim zyrtar, të lëvizjes LGBTQ në botë. Titulli i filmit i referohet tamam një strange, shumë strange. Nëse lexoni tekstin që ka bërë reviu e këtij filmi (i referohet media Pink News), tregon se si ky film mëson, u mëson fëmijëve. Tani unë nuk dua të diskutoj a ka të drejtë komuniteti LGBTQ që të prodhojë filma, të marri një kompani si Disney e që ka qenë modeli botëror i formatit më të mirë edukativ të familjes, të fëmijës. Ka bërë një histori shekullore mbi këtë rol kaq perfekt, që e ka luajtur kaq mirë në dekadat e shkuara, por në këtë moment gjërat kanë ndryshuar. Unë mund t’iu kujtoj në këtë moment debatin midis Desantis dhe CEO-s së Disney-t, në Florida, ku vetë Desantis i tha po të doni mund të largoheni nga ky shtet, por këtu do të zbatoni rregullat e shtetit. Pikërisht për faktin e kësaj agjende. Dhe ky film që shfaqet nesër në Tiranë është problem i Disney-t, por bëhet problem i jonë në momentin jo thjeshtë që shfaqet në kinema, unë nuk mendoj se kemi të drejtën të ndalojmë shfaqjen e një filmi në një kinema. Një film shfaqet sepse është një kontratë private midis një institucioni privat dhe një kompanie private. Problemi qëndron kund tjetër, problemi qëndron tek kurthi tek fshehja. Ne jemi grupi i parë që diskutojmë mbi këtë temë, pasi kjo doli si lajm rreth një javë e gjysëm më parë tek JOQ Albania, me një reportazh shumë korrekt që shpjegonte që në Tiranë do të shfaqet ky film që është pjesë e një debati botëror tashmë, në mediat e botës, se si mund të shfaqet ky film për fëmijët e vegjël dhe a ka një kufi midis asaj që është e dobishme dhe e padobishme për fëmijët dhe a është e dëmshme dhe sa e dëmshme është për fëmijët. Në Shqipëri kjo kaloi pa zhurmë, erdhi, ndërkohë që kishte një muaj që diskutohej në vendet e tjera, për këtë çështje dhe mbi këtë indicie të JOQ Albania-s, iu referuam, analizuam, u informuam, mësuam që nesër është premiera në orën 10 e gjysëm paradite tek Kinema Millenium. Do të jetë edhe pasnesër. Një film i cili nuk ka asnjë të dhënë, në asnjë format në gjuhën shqipe, në asnjë format të detyruar që ka vetë platforma që shfaq, që është Kinema Millenium, në “web sitin” e saj, që ky film ka këtë përmbajtje. Pra është një kurth për prindërit që shkojnë gjithë qef të çojnë fëmijët, të shohin një film të bukur për fëmijë, animacion me kartona të animuar. Pra këtu kemi të bëjmë, si të thuash me 3 element. Elementi i parë që ky film po shfaqet në Shqipëri në heshtje të plotë. Ndërkohë filmi ka reklamë dhe zhurmë të madhe që është një film i bukur për fëmijë. Por i mungon totalisht fakti që ky film që është i bukur për fëmijë, të ketë një informacion se çfarë ka brenda. Sepse prindi duhet ta dijë se ku e çon fëmijën...Elementi i dytë ka të bëjë me faktin, a erdhi dita që në Shqipëri të kemi një debat për



filmat që shfaqen për fëmijë dhe ky është një rast tipik. Sepse në Televizionin Shqiptar në orën e ditës, ku fëmijët janë në shtëpi, sidomos në kohën e Covidit, shfaqeshin filma se si dy djem të vegjël putheshin në buzë. Në Televizionin Shqiptar, në kanalin që është për fëmijë dhe për edukimin. Elementi i tretë ka të bëjë me faktin që ne si Koalicion dhe si Advocate Albania dhe grupe që bashkohemi dhe përfaqësohemi, a duhet të fillojmë të kemi një pozicionim zyrtar, një qëndrim në raport me këto çështje. Në raport dhe me institucionet, edhe me organizatat e komunitetit, edhe mbi të gjitha me median, se në fund fare rruga kush është, është media. Kjo është arsyeja që sot jemi treguar të kujdesshëm që të ftojme edhe mediat, pikërisht për faktin që ky është një komunikim i hapur. Pra janë 3 element. Elementi i parë është urgjenca, ka të bëjë me ditën e nesërme, është e mërkurë, ora 10 e gjysëm. Prindërit nuk e dinë, prindërit po marrin fëmijët dhe po shkojnë në kinema. Do shkojnë 10 prindër me 10 fëmijë, do shkojnë 20 prindër, 30, 40, 100, këtë nuk e di. Është e panjohur për fat sepse është një informacion i munguar në të gjithë të dhënat e Kinema Millenium, mungon çdo lloj e dhëne mbi këtë fakt. Prindërit do shkojnë me fëmijën për dore, gjyshi, gjyshja, zakonisht ata shkojnë i shoqërojnë. Mund të shkojnë vetë fëmijët, varet nga grupmosha, që janë nën 18 vjeç kuptohet. A duhen informuar këta prindër dhe nëqoftëse ka fëmijë të pashoqëruar, a duhet të ketë një informacion edhe për fëmijët e pashoqëruar, informacion korrekt, i kujdesshëm që a duhet të pyesësh babin dhe mamin, përpara se të shohësh këtë film se ky film ka ndonjë gjë. Pra, mendojmë që nesër kemi një situatë që ka një emergjencë që mund të çënojë shëndetin mendor, gjendjen e tij emocionale dhe psikologjike, duke ndikuar negativisht edhe pa e kuptuar tek 1 fëmijë tek 10 apo tek 100, këtë nuk e dimë. Do jenë 10 prind, 100 nuk e dimë. A duhet të veprojmë? A duhet të lëvizim? A duhet të bëjmë diçka? Koha që kemi është shumë e kufizuar. Media që ndodhet këtu është një nga mjetet kryesore, por unë mendoj që sado që ne të përpiqemi nuk arrijmë dotë brenda 12 orësh të parandalojmë një veprim që do të donte të ishte bërë nga një prind që nuk e dinte. Pra, hapi i parë është informimi. A duhet ti informojmë këta prindër? Unë besoj që materiali që dispononi, me pak modifikim njoftimi do të shokonte çdo prind që do ta lexonte këtë tekst të përkthyer me Google Translate, të pa redaktuar të thjeshtë, siç ka dalë furra, siç ka dalë nga media përkatëse. Do të mjaftonte titulli që prindi që kuptoj të bëjë një zgjedhje, nëse do ta çojë fëmijën të shohi këtë film apo jo. Unë besoj që mund të ketë prindër që edhe mund ta çojë fëmijën, pavarësisht këtij informacioni, por është zgjedhja e tyre. Në fund fare edukimi i fëmijës është zgjedhja e tyre. Ne a kemi për detyrë, si mbrojtës të të drejtave ligjore por mbi të gjitha si Koalicioni i mbrojtjes së familjes, i cili ka për detyrë pikërisht të mbrojë jetën dhe familjen, që ta kryej këtë akt. Dhe nëse do të kryhet ky akt, për kohën që kemi në dispozicion, për shkakun që për fat të mirë filmi është vetëm me një shfaqje nesër, ka vetëm nesër në 10 e gjysëm. Pra nuk është se është një film që do të ketë shumë shfaqje dhe do të krijonte vështirësi. Natyrisht që është një orë pak e vështirë, për shkak se njerëzit janë në punë, në shkollë etj etj. Besoj që kemi kohë të shkurtër për të pasur shumë njerëz, por disa njerëz mund t'i kemi që të shërndajnë përball kinemasë, pikërisht tek prindërit, t'iu japin këtë njoftim dhe t'ua bëjnë të qartë që kujdes, ju e dini vetë po ky është një informacion që për këtë film duhet ta keni. Elementi i dytë është a duhet ti drejtohem kinemasë, si një institucion, nëse kjo kinema ka anashkaluar, s'e ka parë, nuk e ka ditur, nuk ka qenë e qartë grupi menaxherial etj etj., apo e ka bërë me qëllim. E ka zgjedhur ta bëjë këtë gjë dhe e ka bërë, si të thuash, me dëshirën e vet ta bëjë këtë gjë. Po a po shkel një të drejtë të njerzve për informimin? A po shkel të drejtat e prindërve

kjo kinema? Natyrisht që unë kam parë legjislacionin shqiptar, kinemanë nuk e pengojmë dotë. Kinemaja është një subjekt privat që zgjedh të japi një film, që e quan brenda rregullave të veta. Por ka dy elemente që ne kemi ku kapemi. Elementi i parë është ajo që ndodh në Amerikë rregullisht, që kur ka një produkt si ky film, në Amerikë organizatat reagojnë dhe i drejtohen dhe ndonjëherë shkojnë edhe tek bojkoti, edhe thirrjet për bojkot, në bojkot të një produkti, të një situatë kohore apo të gjithçkasë. Dhe në Amerikë këto njihen si praktika që bëhet thirrje për bojkotin e kësaj kinemaje. Nesër ne e kemi mundësinë që ta fillojmë me bojkotin e këtij filmi. Pra i drejtohem kinemasë për të kërkuar bojkotin e këtij filmi dhe ti japim kohë 24 orë, që nëse ajo nuk e bllokoi shfaqjen e këtij filmi, apo ti japi informacion prindërve që po ne po shfaqim këtë film, ka këtë informacion. Një akt i dytë mund të ishte, që ne ti bëjmë thirrje të gjithë prindërve që kanë pikëpamje të përafërta me ne, që ta bojkotojmë pa afat një kinema që nuk respekton disa të drejta bazë të prindërve dhe të fëmijëve mbi të gjitha, se në fund fare për fëmijët bëhet nuk bëhet për prindërit. Pra këto janë dy momente që kanë të bëjnë me një urgjencë. Është sot për nesër ose më saktë, sot në mbrëmje për nesër në mëngjes. Që do të thotë jemi brenda një afati prej 12 orësh. Pra, pyetja është a do ketë mundësi ndonjë nga ne të kontribuojë fizikisht nesër në Kinema? Elementi i dytë, unë besoj që ekziston koha e dukur për ti bërë një letër kinemasë dhe për tia dorëzuar rreth orës 9 e gjysëm, 10, në mëngjes. Ti bëjmë me dije, mbase duke e nxjerrë këtë që sot në rrjete sociale këtë fakt, këtë thirrje për bojkot që ne po bëjmë, si të thuash të ndikojë edhe tek kinemaja dhe të ketë një qartësi përpara se ne të shkojmë tek ata. Pra elementi i parë ka të bëjë me emergjencën fizike. Elementi i dytë ka të bëjë pastaj, a do të bëjmë një debat, a do të organizojmë një përballje me institucionet, mbi atë programacion që ata vënë për fëmijët e vegjël. Pra, duhet ti drejtohem Televizionit Shqiptar edhe mediave, për një takim konkret mbi programacionin mbi atë që japin apo çfarë zgjedhin të japin, ku të paktën të jenë të qarta me pozicionet e tyre. Mos ketë kurthe, të ketë qartësi. Nëqoftëse nesër në orën 10, Televizioni Shqiptar do të shfaq një film, ku dy djem të vegjël puthen, në një program kohor për fëmijët, ne të dijme që kjo do e bëjë dhe të reagojmë paraprakisht dhe ti drejtohem edhe atyre që mbahen me taksat tona, se ne paguajmë taksat në fund fare. Kemi edhe ne të drejta. Aty ka një komision drejtues, që quhet Këshilli Drejtues i Televizionit, ka një agjenci që quhet AMA, që monitoron. Pra, ne kemi disa instrumenta, po ne fillimisht duhet ta kalojmë te takimi i parë, te debati i parë, pastaj të avancojmë. E treta ka të bëjë me faktin që, në Shqipëri unë besoj ka ardhur koha që të krijojmë një bllok rezistence, të prindërve ndaj kësaj gjëje. Sepse siç e keni dhe ftesën që ju ka ardh me sms, ne flasim edhe për programe edukimi shkolle, ku programi i trajtimit psiko-social të fëmijëve me projektin e Fondacionit Soros, të financuar nga Bashkimi Evropian me 3.2 milion euro, po avancojnë për të bërë trajnime etj etj, ku nuk ka anjë qartësi. Dhe a duhet ti drejtohem edhe ne Ministrisë së Arsimit të na japi të gjithë të dhënat e kurrikulës? A ka autoritet Koalicioni, ka përfaqëson grup interesi. Ju kujtoj që në gjykatën Kushtetuese, në vitin 2021, është pranuar si grup interesi një komunitet jo formal i parregjistruar, që është Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Pra i gëzojmë të gjithë të drejtat ligjore që edhe ne që jemi këtu, edhe një grup mbase më i madh ti drejtohem institucioneve për një transparancë të plotë sipas ligjit “Për të drejtën e informimit”, që brenda 10+4 ditësh kanë detyrim të na japin çdo përgjigje mbi këtë program. Ky program po avancojnë ndërkohë. Unë do doja që edhe E. R., si një nga aktorët që ka kundërvepruar i pari në këtë komunikim me institucionet arsimore, si të thuash me bordin

*arsimor të shkollës, me drejtorinë e shkollës, si të thuash të mund të na avancojë më shumë në këtë gjë. Dhe e fundit është që ne jemi përballë një realiteti që po evolon, ndërkohë që në këtë moment thirrëmi dhe ne, si të thuash, në reaksionin përkatës, pasi kjo agjendë globaliste po përparon, në dëm të fëmijëve, në prekjen më të dukshme siç është dita e nesërme në orën 10 e gjysëm. Dhe kjo është dhe hapja e debatit për këtë temë. ”*

Referuar diskutimeve të sipërcituara të A. G., rezulton se fokusi i takimit të mbajtur me datë 23.11.2022, ka qenë ndalimi i shfaqjes së filmit “Strange World”, në Kinema Millenium me arsyetimin si më poshtë:

- informimi i prindërve mbi titullin e përkthyer jo korrekt, pasi nga anglishtja në shqip do të përkthehej “Botë e Çuditshme”, ndërsa nga ana e Kinema Millenium ishte përkthyer “Botë e Mrekullueshme”;
- informimi i prindërve dhe familjarëve të tyre mbi tematikën edhe përmbajtjen e filmit, pasi nuk ka patur asnjë informacion rreth kontetit të tij dhe prindërit kanë qenë të pa informuar.

Referuar përsa më sipër, Komisioneri saktëson se, ka analizuar vetëm ato pasazhe, që janë vënë në dipozicion nga palët në proces, të cituara më lart, të cilat i ka vlerësuar se potencialisht kishin premisa për një gjuhë që shkon në tejkalim të lirisë së shprehjes. Fakti që takimi i mbajtur më datë 23.11.2022, nuk është transkriptuar i plotë, nuk cenon vërtetësinë e transkriptimit të pjesëve të diskutimit të A. G. të pasqyruara në këtë vendim. Kjo pasi, shprehjet e analizuar të A. G., Komisioneri është mbështetur në intervistën e publikuar në faqen e tij në Facebook. Diskursi i mbajtur dhe përsa rezulton në videon administruar nga Komisioneri, është transkriptuar i plotë dhe është cituar më lart në këtë vendim.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”. Intervista e publikuar në faqen e tij të Facebook-ut<sup>25</sup>, të A. G., e cila është objekt shqyrtimi në këtë çështje, është bërë publike dhe si të tillë deklaratimet e subjektit konsiderohen të njohura publikisht dhe Komisioneri ka administruar regjistrimin ku janë bërë deklaratimet të cilat janë marrë në shqyrtim nga Komisioneri.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gurë themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe i të drejtës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare. Të gjithë personat, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual,

<sup>25</sup> <https://web.facebook.com/profile/100050576645761/search/?q=strange%20world>

identiteti gjinor ose karakteristikat e seksit, kanë të drejtën të gëzojnë mbrojtje nga çdo lloj forme diskriminimi.

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese. Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinionëve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është objekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për 'informacionet' ose 'idetë' që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie pa të cilat nuk ka 'shoqëri demokratike'. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo 'formalitet', 'kusht', 'kufizim' ose 'dënim' i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur". (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të

parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e seksit, ndalon çdo formë të shprehjes në publik, me çdo mjet, të promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes për këto shkaqe. Këto shprehje, përbëjnë “gjuhë urrejtje”, e cila sipas ligjit përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike.

Kufizimi është vendosur bazuar në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar dhe për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në rastin konkret për mbrojtjen nga diskriminimi të personave që i përkasin komunitetit LGBTI. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

Është fakt që në Shqipëri personat LGBTI ndeshen me një sërë veprimesh paragjyquese e diskriminuese, shoqëruar dhe me një gjuhë të urrejtjes, dhunë e lëndime. Barazia de-jure jo gjithmonë respektohet dhe shoqërohet me drejtësi de-facto.

Si pasojë sigurimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, jo-diskriminuese dhe të sigurt për personat LGBTI në Shqipëri me akses më të mirë në shërbimet publike dhe mbështetje të specializuara, përmirësim të kuadrit ligjor dhe zbatimit, si dhe rritjes së aksesit në sistemin e drejtësisë të personave LGBTI, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 700, datë 18.11.2021 është miratuar “*Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI, për vitet 2021-2027*”, i treti plan veprimi në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt personave LGBTI në Shqipëri, duke u fokusuar në masa më të forta kundër diskriminimit dhe kimit të urrejtjes ndaj personave LGBTI në të gjithë vendin.

Rekomandimi CM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, në pikën 9 të tij, citon ndër të tjera se: “*Vitet e fundit, gjuha e urrejtjes është përhapur gjithnjë e më shumë përmes internetit. Parandalimi dhe luftimi i gjuhës së urrejtjes në internet paraqet sfida specifike, pasi ajo mund të shpërndalet si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash. Ndonjëherë mund të mbetet vazhdimisht i disponueshëm në internet (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata), Delfi AS kundër Estonisë, nr.*



64569/09, 16 qershor 2015 [Dhoma e Madhe], § 110; dhe Annen kundër Gjermanisë, nr. 3690/10, 26 nëntor 2015, § 67). Shtetet anëtare kanë detyrimin për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore edhe në mjedisin dixhital (§ 1.1.3 i CM/Rec(2018)2 mbi rolet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësve të internetit). Kjo përfshin detyrën për të mbrojtur individët kundër shkeljeve, përfshirë shkeljet e mundshme, të kryera nga persona të tjerë privatë dhe organizatat (Platforma “Ärzte für das Leben” kundër Austrisë, nr. 10126/82, 21 qershor 1988, §§ 32 e në vazhdim”.

Neni 3/8 i ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon gjuhën e urrejtjes, në çdo formë të shprehjes në publik dhe me çdo mjet. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehjet e realizuara nëpërmjet fjalëve dhe në mënyrë publike, pasi gjuha në shqyrtim e përdorur nga A. G., në takimin e datës 23.11.2022, është bërë në një platformë publike, siç janë mediat dhe rrjetet sociale, përfshihen në mjetet e përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

A. G. prapësoi se, nuk kishte bërë në asnjë moment thirrje nxitëse për të ngjallur urrejtje por gjithçka e kishte fokusin tek mungesa e informacionit rreth filmit “Strange World”, që do të transmetohej në kinema. Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri thekson se, sikurse rezultojnë edhe nga përkufizimi i gjuhës së urrejtjes dhe nxitja e urrejtjes mund të rezultojë edhe nga deklaratat që shqetësojnë, fyejnë, stigmatizojnë ose përbëjnë një stereotip negativ dhe që bazohen në një nga shkaqet e mbrojtura duke përfshirë edhe shkaqet e orientimit seksual, identitetit gjinor.

Në këtë kontekst, GJEDNJ në çështjen Féret kundër Belgjikës (*Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009*) është shprehur se: “..... nxitja e urrejtjes nuk nënkupton domosdoshmërisht thirrje për kryerjen e akteve të dhunës apo ndonjë akti tjetër të paligjshëm. Sulmet ndaj grupeve të veçanta të popullsisë të kryera nëpërmjet fyerjes, talljes apo shpifjes, mund të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste, përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.....”

Gjuha e urrejtjes konsiderohet e tillë edhe kur efekti që prodhon apo krijon pritshmërinë se mund të nxisë drejt kryerjes së akteve të dhunës, frikësimit armiqësisë apo diskriminimit.

Për të vlerësuar nëse ekziston rreziku që aktet e promovuara ose të nxitura nga gjuha e urrejtjes të ndodhin, Komisioneri ka marrë në konsideratë rrethanat e mëposhtme, në përputhje me frymën e Rekomandimit Nr. 15 të ECRI-t.

Duke ju referuar përmbajtjes së diskutimeve, A. G. është shprehur se:

“Elementi i dytë ka të bëjë me faktin, a erdhi dita që në Shqipëri të kemi një debat për filmat që shfaqen për fëmijë dhe ky është një rast tipik. Sepse në Televizionin Shqiptar në orën e ditës, ku fëmijët janë në shtëpi, sidomos në kohën e Covidit, shfaqeshin filma se si dy djem të vegjël putheshin në buzë.”; **“Pra, mendojmë që nesër kemi një situatë që ka një emergjencë që mund**

**të cënojë shëndetin mendor, gjendjen e tij emocionale dhe psikologjike, duke ndikuar negativisht edhe pa e kuptuar tek 1 fëmijë tek 10 apo tek 100, këtë nuk e dimë**”; “Pra i drejtohem kinemasë për të kërkuar bojkotin e këtij filmi dhe ti japim kohë 24 orë, që nëse ajo nuk e bllokoi shfaqjen e këtij filmi, apo ti japi informacion prindërve që po ne po shfaqim këtë film, ka këtë informacion. Një akt i detyrues mund të ishte, që ne ti bëjmë thirrje të gjithë prindërve që kanë pikëpamje të përafërta me ne, që ta bojkotojmë pa afat një kinema që nuk respekton disa të drejta bazë të prindërve dhe të fëmijëve mbi të gjitha, se në fund fare për fëmijët bëhet nuk bëhet për prindërit”; “Nëqoftëse nesër në orën 10, Televizioni Shqiptar do të shfaq një film, ku dy djem të vegjël puthen, në një program kohor për fëmijët, ne të dijmë që kjo do e bëjë dhe të reagojmë paraprakisht dhe ti drejtohem edhe atyre që mbahen me taksat tona, se ne paguajmë taksat në fund fare”; “Dhe e fundit është që ne jemi përballë një realiteti që po evolon, ndërkohë që në këtë moment thirrja dhe ne, si të thuash, në reaksionin përkatës, pasi kjo agjendë globaliste po përparon, në dëm të fëmijëve, në prekjen më të dukshme siç është dita e nesërme në orën 10 e gjysëm. Dhe kjo është dhe hapja e debatit për këtë temë”.

A. G., në fjalën e tij thekson se shfaqja e këtij filmi mund të cënojë shëndetin mendor, gjendjen emocionale dhe psikologjike të fëmijëve, duke ndikuar negativisht tek ata. Në këtë mënyrë personat LGBTI portretizohen si persona të cilët paraqesin rrezik për këtë kategori të veçantë, siç janë fëmijët.

Debati dhe diskutimi për çështje të ndryshme është i nevojshëm veçanërisht për tema apo çështje sensitive, që janë në interes të opinionit të gjerë. Diskutime mbi informacione jo të bazuara shpesh çojnë në krijimin e paragjykimeve dhe stigmatizimin e personave për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë personat LGBTI si kërcënim për shoqërinë apo fëmijët në rastin konkret, stimulojnë frikën, nxisin qëndrime negative, nxisin diskriminimin dhe për këtë arsye ato janë në kundërshtim me ligjin. Gjuha e përdorur nga A. G., stigmatizon personat e komunitetit LGBTI duke i etiketuar ata në një mënyrë negative dhe me attribute të pavërteta.

Gjuha e përdorur nga A. G., është përcjellë në një kontekst të një debati i lindur si pasojë e shfaqjes së filmit “Strange World”. Si pasojë e këtij debati, nga pala ankuese janë konstatuar kërcënime në rrjetet sociale, shprehje fyese dhe diskriminuese kundrejt anëtarëve të komunitetit LGBTI<sup>26</sup>. Komisioneri ka konstatuar se gjuha e përdorur ka nxitur komente nga persona të ndryshëm në platformat sociale si “Youtube”, “Facebook” apo “Tik Tok”, komente të cilat janë fyese, denigruese dhe në disa raste edhe janë përdorur fjalë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë përbëjnë thirrje për akte dhune. Gjuha e përdorur dhe e shpërndarë në një mjedis shoqëror ku homofobia dhe transfobia janë të theksuara dhe paraqesin një fenomen shqetësues, shton mundësinë që të nxiten akte frikësimi, armiqësimi apo diskriminimi ndaj personave LGBTI që targetohen në rastin konkret.

<sup>26</sup> <https://www.oranews.tv/lifestyle/g...-ka-agjenda-qe-synojne-degjenderizimin-e-femijeve-i1065828>  
<https://www.youtube.com/watch?v=IOBOR3YORzw>  
<https://www.tiktok.com/@joqnews/video/7169615960192650501>  
<https://www.facebook.com/watch/?v=1876396269376500>

Duke qenë një avokat i njohur dhe mbrojtës i shumë kauzave në shoqëri, A. G., ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Në mënyrë të veçantë rezultojnë se A. G., është person shumë aktiv në jetën publike nëpërmjet prezencës së tij në media. Duke u bazuar tek statusi i tij, ai mbart detyrime të shtuara, në raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet e ndryshme.

Komisioneri gjykon se nuk është e gabuar të informohet publiku dhe të diskutohen tema sensitive që prekin grupe të ndryshme vulnerabël, por veshja dhe referimi i mendimeve apo perceptimeve personale, sidomos me konotacion negativ, në momentin që nuk disponohet ekspertiza e duhur dhe e nevojshme për tema specifike dhe nuk shërbejnë për informim, përbën një qëndrim të gabuar dhe krijon premisa për paragjykime si dhe stero tipe negative. Në këtë kuptim, referimi i A. G. se *shfaqja e filmit, mund të çënojë shëndetin mendor, gjendjen e tij emocionale dhe psikologjike, duke ndikuar negativisht edhe pa e kuptuar tek fëmijët*, përbën një qëndrim jo profesional, jo informues, paragjykes dhe nga ana tjetër krijon negativitet kundrejt një grupi specifik shoqëror që janë personat LGBTI duke i shqetësuar ato dhe duke krijuar premisa për sjellje diskriminuese kundrejt tyre.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Macate vs. Lituania* (Application no. 61435/19) në 23 Janar 2023<sup>27</sup> vlerësoi se: *“Etiketimi i një libri me përralla si i dëmshëm për fëmijët vetëm për shkak të përmbajtjes LGBTI shkelte Konventën”*.

Çështja *Macate* kundër Lituanië (aplikimi nr. 61435/19) kishte të bënte me një libër me përralla për fëmijë që përmbante tregime për martesën e të njëjtit seks. Shpërndarja e librit ishte pezulluar menjëherë pas botimit të tij në vitin 2013. Ajo kishte rifilluar një vit më vonë pasi libri ishte etiketuar si mundësisht i dëmshëm për fëmijët nën moshën 14 vjeç. Ky është rasti i parë në të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar kufizimet mbi literaturën për marrëdhëniet e të njëjtit seks të shkruar posaçërisht për fëmijët.

Në këtë vendim Gjykata ndër të tjera ka arsyetuar:

209. Megjithatë, duhet theksuar se Gjykata ka refuzuar vazhdimisht të miratojë politika dhe vendime që mishëronin një paragjykim të predispozuar nga ana e një shumice heteroseksuale kundër një pakice homoseksuale (shih, mes shumë autoriteteve të tjera, Bayev dhe të tjerë, të cituara më sipër, § 68). Në mënyrë të përsëritur është shprehur se, ashtu si dallimet e bazuara në seks, dallimet e bazuara në orientimin seksual kërkojnë justifikim “arsye veçanërisht bindëse dhe me peshë”. Dallimet e bazuara vetëm në konsideratat e orientimit seksual janë të papranueshme sipas Konventës (shih Salgueiro da Silva Mouta kundër Portugalisë, nr. 33290/96, § 36, ECHR

<sup>27</sup> [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-222072%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-222072%22]}) /përkthim i KMD

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

1999 IX; E.B. kundër Francës [GC], nr. 43546/02, § 96, 22 janar 2008; Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë [GC], nr. 29381/09 dhe 32684/09, § 77, ECHR 2013 (ekstrakte); dhe Bayev dhe të tjerët, cituar më lart, § 68).

210. Në respekt të interesit më të lartë të fëmijës, Gjykata ka konstatuar tashmë, në disa raste, se nuk kishte në dispozicion prova shkencore apo të dhëna sociologjike që sugjeronin që thjesht përmendja e homoseksualitetit, ose debati i hapur publik për pakicat seksuale, statusi social, do të ndikonte negativisht tek fëmijët (shih Alekseyev kundër Rusisë, nr. 4916/07 dhe 2 të tjerë, § 86, 21 tetor 2010)...

211. Në të njëjtën mënyrë, organe të ndryshme ndërkombëtare, si PACE, Komisioni i Venecias, ECRI, Parlamenti Evropian dhe Eksperti i Pavarur i OKB-së për orientimin seksual dhe identitetin gjinor, kanë kritikuar ligjet që synojnë të kufizojnë aksesin e fëmijëve në informacione mbi orientimet seksuale, me arsyetimin se nuk ka prova shkencore që një informacion i tillë, kur paraqitet në mënyrë objektive dhe të përshtatshme për moshën, mund të shkaktojë ndonjë dëm për fëmijët. Përkundrazi, organet në fjalë kanë theksuar se është mungesa e një informacioni të tillë dhe stigmatizimi i vazhdueshëm i personave LGBTI në shoqëri që është i dëmshëm për fëmijët (shih materialin përkatës ndërkombëtar në paragrafët 105-122 më lart).

215. Për më tepër, Gjykata është e vendosur në mendimin e saj se masat që kufizojnë aksesin e fëmijëve në informacione për marrëdhëniet e të njëjtit seks vetëm në bazë të orientimit seksual kanë implikime më të gjera sociale. Masa të tilla, qofshin ato të parashikuara drejtpërdrejtë në ligj ose të miratuara në vendime rast pas rasti, tregojnë se autoritetet kanë një preferencë për disa lloje marrëdhëniesh dhe familjesh mbi të tjerat - se ata i shohin marrëdhëniet e sekseve të ndryshme si më të pranueshme nga ana shoqërore dhe më me vlerë se marrëdhëniet e të njëjtit seks, duke kontribuar kështu në stigmatizimin e vazhdueshëm të këtyre të fundit. Prandaj, ndalime të tilla, sado të kufizuara në shtrirjen dhe efektet e tyre, janë të papajtueshme me nocionet e barazisë, pluralizmit dhe tolerancës të qenësishme në një shoqëri demokratike (shih Bayev dhe të tjerët, cituar më lart, § 83).

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur deklaratat. Komisioneri vlerëson se, përhapja e ligjëratave të tilla nëpërmjet medias audiovizive dhe mediave sociale nëpërmjet internetit, janë shumë më e fuqishme dhe arrin te një publik shumë të gjerë. Mediat sociale apo interneti, siç është cituar edhe në Rekomandimin CM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, kanë një mundësi shpërndarje si kurrë më parë në të gjithë botën brenda pak sekondash.

Komisioneri vlerëson se, gjuha e përdorur nga A. G., krijon në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBT. Në çështjen Féret kundër Belgjikës<sup>28</sup>, GJEDNJ, ka mbajtur

---

<sup>28</sup> Féret kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 15615/07, 16 korrik 2009

qëndrimin se: “.....një ligjëratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut – e veçanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirinformuar – ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje .....

Edhe pse deklaratat e bëra nga A. G., nuk drejtohen kundër individëve të caktuar, anëtarët e komunitetit LGBTI, portretizohen dhe etiketohen si modele negative vetëm për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Këto deklarata edhe pse nuk janë një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj një personi të caktuar, mund të kuptohen si deklarata që nxisin urrejtje.

Duke ju rikthyer çështjes Féret kundër Belgjikës, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: “.....ndonëse deklaratat e ankuesit nuk drejtoheshin kundër individëve të caktuar – anëtarë të komuniteteve të emigrantëve/refugjatëve, ata i shihnin ata kolektivisht nën një dritë negative dhe i portretizonin si kontingjent krimi dhe oportunist të prirur për të përfituar nga rezidenca e tyre në Belgjikë”. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke referuar në konkluzionet e mësipërme të çështjes Féret kundër Belgjikës, thekson në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë<sup>29</sup>, se: “diskriminimi në bazë të orientimit seksual është po aq serioz sa diskriminimi për shkak të “racës, origjinës, ose ngjyrës”.

Personat e komunitetit LGBTI kanë qenë dhe vazhdojnë ende të jenë subjekte të homofobisë, transfobisë dhe formave të tjera të intolerancës dhe diskriminimit. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se për shkak të vulnerabilitetit të këtij grupimi është e nevojshme që të ndërmerren masa të menjëhershme për të ndaluar çdo përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe për të siguruar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut të këtyre personave.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e Firmës Feryn (*Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër Firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008*), ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet një viktimë. Komisioneri vlerëson se në çështjen në fjalë, gjuha e përdorur përcjell një gjuhë urrejtje të pajustificuar, saqë edhe në mungesë të identifikimit të një individi konkret si viktimë diskriminimi, mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese, do të cënonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 8 parashikon se: “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.”.

Siç vërehet, në nenin e sipërcituar referohet “...çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet...”, çka do të thotë që në kuptim të ligjit çdo mënyrë publike e të shprehurit që krijon

---

<sup>29</sup> GJEDNJ, Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, datë 09 shkurt 2012

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)



premisën e parashikuar në këtë formë diskriminimi është dhe duhet hetuar. Aq e vërtetë është kjo sa është praktikë e gjerë e GJEDNJ që të hetojë dhe të shprehet edhe në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes me mjete tjera jo tradicionale si rrjete sociale, portale on line apo edhe komente nga përdoruesit.

Për këtë qëllim sjellim në vëmendje standardet e Këshillit të Evropës në lidhje me gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet Rekomandimit nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për luftimin e gjuhës së urrejtjes*”<sup>30</sup> (materiali në link), në bazë të cilit është mbështetur edhe legjislatori shqiptar në përkufizimin e kësaj forme diskriminimi në Ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Po ashtu, edhe jurisprudencën dhe vendime konkrete të GJEDNJ-së në lidhje me format dhe mjetet e shprehura të gjuhës së urrejtjes dhe kuptimit të saj nga kjo gjykatë.<sup>31</sup>

Në frymë të këtij rekomandimi dhe jurisprudencës së sipërcituar, shqetësimi lidhet me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, pavarësisht nga mjeti i përdorur. Sidomos në rastet kur personi i prezumuar që ka përdorur gjuhë urrejtje e ka bërë këtë me zë dhe me figurë, i identifikuar me emër dhe mbiemër, në një rrjetet sociale, ku është aksesuar nga çdo njeri dhe shpërndarë nga një numër i konsiderueshëm personash.

Në përfundim, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes, rëndësi ka që përdorimi dhe emetimi i saj, pavarësisht mjetit të përdorur, ka ndodhur ose/dhe vazhdon të ndodhë dhe krijon shqetësim në shoqëri e akoma më tepër në grupe shoqërore të konsideruara pakica dhe të njohura si sitematikisht të diskriminuara.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga A. G., përbën gjuhë urrejtje kundër personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 dhe 24 të Kushtetutës, nenet 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neneve 18 dhe 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi i gjuhës së urrejtjes është i domosdoshëm dhe proporcional.

---

<sup>30</sup> <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

<sup>31</sup> Çështja Jersild kundër Denimarkës 23 Shtator 1994 – Fragmente nga dokumentar;

Çështja Gündüz kundër Turqisë 4 Dhjetor 2003 – Debat televiziv;

Çështja Erbakan kundër Turqisë 6 Korrik 2006 – Fjalim publik;

Çështja Pavel Ivanov kundër Rusisë 20 Shkurt 2007 – Artikull i shkruar;

Çështja Féret kundër Belgjikës 16 July 2009 – Fletëpalosje;

Çështja Delfi AS kundër Estonisë 16 Qershor 2015 – Koment në një portal në internet;

Çështja Belkacem kundër Belgjikës 27 June 2017 – Komentë në Youtube;

Çështja Šimunić kundër Kroacisë 22 Janar 2019 – mesazhe në një ndeshje futbolli;

Çështja Beizaras dhe Levickas kundër Lithanisë 14 January 2020 – Komentë në Facebook;

Çështja Lilliendahl kundër Islandës 12 Maj 2020 – Komentë në një artikull on line;

Çështja Zemmour v. France 20 dhjetor 2022 – Deklaratë në emission televiziv;

Çështja Valaitis kundër Lithuanisë 17 January 2023 – Komentë në internet

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i A. G., që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “gjuhës së urrejtjes” të personave që i përkasin komunitetit LGBTI, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si pasojë e gjuhës së përdorur nga A. G., në takimin e mbajtur më datë 23.11.2022, transmetuar *live* në rrjetin social *Facebook*.
2. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar procedurën administrative për pjesën e ankesës që lidhet me pretendimet e ngritura kundër A. P., për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura apo qëllimi i saj, është bërë i pamundur.
3. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, A. G., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes kundër personave LGBTI dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
4. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, A. G., në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për rishikimin e videoregjistrimit të publikuar nga ana e tij në rrjetet sociale, duke hequr prej tij shprehjet e konstatuara si diskriminuese në këtë vendim.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, A. G., duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
6. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.

7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Orientimi seksual dhe identiteti gjinor)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

(Forma: Gjuhë urrejtje)